

**VIOLETA SHAMKU**

# **MUZIKA**

**LIBËR MËSUESI**

**Klasa IV**

**BOTIME**



**BOTIME**



Paraqitja grafike: Elidor KRUJA  
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë  
ISBN: 978-9928-233-02-8

© Botime Pegi, qershor 2018

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

---

**Botime Pegi:** tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;  
**e-mail:** botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al  
**Spektori i shpërndarjes:** cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;  
**e-mail:** marketing@botimepegi.al  
**Shtypshkronja Pegi:** cel: +355/ 069 40 075 01;  
**e-mail:** shtypshkronjapegi@yahoo.com

---

# **Përmbajtje**

## **Hyrje**

Pse shërben ky libër?  
Çfarë synon ky libër?  
Çfarë përmban ky libër?

## **Kompetencat dhe kuptimi i tyre**

Lidhja e muzikës me *kompetencat kyçe*  
Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare  
Kuptimi i a) *kompetencave lëndore muzikore*, b) *tematikave* dhe lidhja ndërmjet tyre.

## **Planifikimi i kurrikulës - kuptimi dhe zbatimi**

Planifikimi vjetor - “Muzikë”  
Planifikimi sipas 3 periudhave (i ndërthurur)  
Planifikimi ditor

## **Vlerësimi**

Llojet e vlerësimit në klasën e katërt/shkallën e dytë (arsimi fillor).





## 1. Hyrje

I dashur koleg!

Lënda e muzikës synon të edukojë dhe formojë nxënësit nga pikëpamja muzikore, duke i orientuar ata me krijimtari drejt kuptimit të veçorive të ligjërimit muzikor nga më e thjeshta te më e ndërlikuara përmes gjuhës dhe komunikimit muzikor, drejt marrjes pjesë dhe interpretimit në veprimtaritë muzikore individuale dhe në grup përmes teknikave dhe procesit muzikor, drejt formimit dhe krijimit të një vlerësimi dhe qëndrimi artistik në njohjen me veprat muzikore.

Nxënësi/ja tashmë njeh mjaft mirë dy elementet bazë *ritmin* dhe *melodinë*. Ritmin në këtë klasë do të mësohet nëpërmjet gjatësive të notave duke krijuar ritme me dy, tri dhe katër goditje.

Këngët për fëmijë, do të jenë të përshtatshme për nga karakteri, përmbajtja e shtrirja e vokalit (zërit). Ato mësohen për të formuar një kulturë vokale. Luajtja me instrumentet me goditje dhe shoqërimi i këngëve është një tjetër veprimtari që do të kryejnë nxënësit. Krijimi i modeleve ritmike përmes ligjërimit të vargjeve, shoqërimit me lëvizje trupore, me shuplaka, janë veprimtari që zhvillohen në këtë nivel moshe dhe intelekti të fëmijëve. Prandaj zhvillimi i muzikës në shkollë është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve/eve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

### *Pse shërben ky libër?*

Ky libër do t'ju shërbejë mësuesve të muzikës, si një *udhërrëfyes* ku ata do të demonstrojnë aftësitë e tyre edukuese dhe profesionale në lëndën e muzikës, për zbatimin më së miri të risive dhe të qasjes së re të kurrikulës me kompetenca.

### *Çfarë synon ky libër?*

Mësimdhënia bazuar në *kompetenca*, e trajtuar përmes këtij libri, do të shërbejë për të gjithë mësuesit e muzikës, të ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *kurrikula bërthamë e arsimit fillor, programet mësimore, nivelet e arritjes së kompetencave të arsimit fillor*, të cilat përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

- a) planifikimin e të nxënit;
- b) metodologjinë e mësimdhënies;
- c) vlerësimin e të nxënit bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Qëllimi i këtij libri është të orientojë dhe të ndihmojë mësuesit që japin mësim në klasën e katërt, për të përmbushur synimet e kurrikulës së muzikës, për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe atyre kyçe, për të planifikuar dhe për të realizuar detyrat

e tyre si mësimdhënës/e të kësaj lënde, në përshtatje me dokumentet zyrtare dhe fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

### ***Çfarë përmban ky libër?***

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së katërt, të shkallës së dytë të lëndës *Muzikë*, miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2014 dhe merr përsipër:

**të sqarojë** të gjitha çështjet e planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit, që duhet të zbatohet çdo mësues që jep mësim në klasën e katërt;

të udhëzojë për **formatet** e reja: *plani vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxëniet, formatet e vlerësimit* etj., me të cilat mësuesit duhet të punojë gjatë një viti shkollor.

Ky libër ofron ose sugjeron modele, por **nuk i dikton** ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxëniet dhe metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

**AUTORJA**



## 2. PROGRAMI MËSIMOR, KOMPETENCAT DHE KUPTIMI I TYRE

Programi mësimor zhvillon përmbajtje të caktuara mësimore dhe muzikore që i përgjigjen moshës dhe nivelit intelektual të nxënësve/eve të kësaj klase dhe qëllimit që ka lënda. Gjithashtu, ky program krijon kushte për ndërtimin e **kompetencave të lëndës së muzikës** si dhe të **kompetencave kyçe**, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën; realizimin e **temave ndërkurrikulare** apo **lidhjes së muzikës me fushat e tjera kurrikulare**, të cilat janë gjithashtu komponentë të rëndësishëm për kontributin e muzikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë edukimit dhe formimit të nxënësve. Muzika e klasës së katërt bën pjesë në **shkallën e dytë**.

### 1.1. Kompetencat kyçe dhe muzika

**Kompetenca** përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

1. kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
2. kompetenca e të menduarit;
3. kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
4. kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
5. kompetenca personale;
6. kompetenca qytetare;
7. kompetenca digjitale.

**Diagrami 1: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës, shkalla e dytë.**

| <b>SHKALLA E DYTË</b>  |  |
|--|--|
| <b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>  |  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike.</li> <li>• Kupton mesazhet nëpërmjet simboleve muzikore që u drejtohen.</li> <li>• Shpjegon në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve dhe formave artistike.</li> <li>• Komunikon në mënyrë të pavarur dhe krijuese mundësitë e të shprehurit në muzikë.</li> </ul>                   |  |
| <b>Kompetenca e të menduarit</b>   |  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mendon në mënyrë krijuese në situata të ndryshme të të menduarit.</li> <li>• Përpunon njohuritë në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.</li> <li>• Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.</li> <li>• Demonstron realizimin e një krijimi/interpretimi në një veprimtari muzikore.</li> </ul> |  |
| <b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b>   |  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mjetet për të realizuar një krijim muzikor.</li> <li>• Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim muzikor.</li> <li>• Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën muzikore.</li> </ul>  |  |
| <b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b>   |  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.</li> </ul>  |  |
| <b>Kompetenca personale</b>  |  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillon besimin te vetja gjatë krijimit/performimit/vlerësimit muzikor respekton punën e vet dhe të të tjerëve.</li> <li>• Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.</li> </ul>  |  |
| <b>Kompetenca qytetare</b>   |  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</li> </ul>   |  |
| <b>Kompetenca digjitale</b>  |  |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor mjetet: magnetofon, video CD, DVD, kompjuter etj.</li> </ul>   |  |

## 1.2. Kompetencat dhe tematikat në lëndën e muzikës:

- a) kompetencat lëndore muzikore;  
b) tematikat që përfaqësojnë përmbajtjen muzikore përgjatë klasës së katërt.

**Qasja e bazuar në kompetenca** është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në çdo fushë të nxëni në gjithë arsimin fillor. Në muzikë, zhvillohen dhe ndërtohen përmes kompetencave të **krijimit, të interpretimit dhe të vlerësimit**. Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së muzikës dhe zhvillohen nëpërmjet përmbajtjeve të tyre. Kompetencat lëndore të muzikës lidhen dhe plotësojnë në mënyrë logjike e metodike **kompetencat kyçe**. Zotërimi i muzikës nënkupton **zotërimin e kompetencave muzikore**, që do të thotë aftësia për të krijuar, për të interpretuar një këngë apo lojë muzikore dhe për të vlerësuar duke gjykuar dhe duke përdorur muzikën në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata në të cilat muzika luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm.


Me kurrikulën e re, muzika është strukturuar me tri (3) kompetenca, të cilat renditen si më poshtë:

| Kompetencat lëndore                    | Përshkrimi i kompetencave  |
|--|--|
| <b>Krijimi muzikor</b>                 | Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdor ide të ndryshme, duke përdorur elementet dhe gjuhën muzikore;</li> <li>- eksperimenton duke zbuluar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike;</li> <li>- organizon krijimin e vet muzikor, sipas elementeve të gjuhës muzikore;</li> <li>- ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.</li> </ul>   |
| <b>Performimi/interpretimi muzikor</b> | Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave të ndryshme muzikore (këngë/lojëra muzikore, fragmente të thjeshta muzikore);</li> <li>- zbaton teknika dhe procese të ndryshme muzikore gjatë këndimit dhe luajtjes me instrumente;</li> <li>- respekton rregullat e performimit/interpretimit muzikor gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente;</li> <li>- ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë.</li> </ul> |
| <b>Vlerësimi i veprave muzikore</b>    | Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegon me fjalor të thjeshtë këngë/lojëra dhe veprat muzikore të thjeshta.</li> </ul>   |

**Tematikat përmbajtjesore**, janë ato tematika që zhvillohen përgjatë programit dhe krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë *njohuritë, shkaktësitë, qëndrimet dhe vlerat*, në funksion të *kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe*.

Përshkrimi i secilës **tematikë** dhe i **kompetencave lëndore** që duhet të demonstrojë nxënësi/ja lidhur me tematikat përkatëse.

**Diagrami: Kompetencat kyçe dhe lëndore, që formohen përmes tematikave të muzikës.**



Nëse do të bënim një shpjegim të diagramit, vërejmë se *kompetencat kyçe* dhe *kompetencat lëndore* zhvillohen përmes *tematikave* të lëndës së muzikës, ku në qendër të mësimdhënies (procesit) është nxënësi/ja.

### 1.3. Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj si me: kërcimin, artin pamor, teatrin, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul, si me: matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore etj. Kështu mësuesit duhet t'u japin mundësinë nxënësve/eve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat që ata kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtëjshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të muzikës me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.



### 3. PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES

Planifikimi i kurrikulës është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es që zgjat përgjatë gjithë vitit shkollor dhe që shoqërohet me përgatitjen e dokumenteve përkatëse. Koha mësimore sipas tematikave për secilën klasë Lënda e muzikës, klasa e katërt, zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për secilën klasë në arsimin fillor.

| Tematikat      | Gjuha dhe komunikimi muzikor | Teknika dhe procese | Historia, muzika dhe shoqëria | Orët gjithsej |
|----------------|------------------------------|---------------------|-------------------------------|---------------|
| Klasa e katërt | 8                            | 22                  | 5                             | 35 orë        |

Planifikimi i dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi kërkon: *liri, elasticitet dhe përgjegjshmëri në planifikim*. Këto dokumente janë: *planifikimi vjetor i lëndës së muzikës, planifikimi sipas periudhave (i ndërthur sipas tematikave) dhe planifikimi ditor*.

Planifikimi vjetor i programit është i ndërtuar me periudha, ku secila periudhë ka një grup të caktuar orësh, në bazë të periudhës kohore të përcaktuar në udhëzimin e çdo fillim të vitit të ri shkollor. Për shkak të specifikës që ka, lënda e muzikës duhet t'i ndërthurë tematikat dhe njohuritë me njëra-tjetrën, për të mos e bërë monotone orën mësimore dhe lëndën përgjatë:

- a) planifikimit vjetor të periudhave;
- b) planifikimit vjetor temë për temë.

Periudhat në modelet e mëposhtme janë ndarë, duke bërë një përllogaritje të përafërt të zgjatjes së shkollës përgjatë këtyre periudhave *me + ose* – që çdo mësues i llogarit vetë.



## PLANIFIKIMI VJETOR SIPAS PERIUDHAVE

Planifikimi i temave mësimore bëhet nga vetë mësuesi. Kujdes! Këngët mësohen në 2 orë mësimore ndonjëherë edhe në 3 orë. Informacioni muzikor (GJKM) mësohet përmes veprimtarive muzikore, të cilat mund të zgjasin ndonjëherë edhe 2 orë për t'i përforcuar ato më mirë. Dëgjimi muzikor dhe përjetimi i emocioneve përmes muzikës, bëhet në një ose dhe 2 orë. Edhe pse në planin vjetor të mëposhtëm periudhat janë të planifikuara me 20 tema mësimore, Ju i planifikoni ato sipas nevojave të nxënësit dhe mundësive tuaja. Totali i orëve të mëposhtme është 35 orë vjetore, ku brenda këtyre orëve, mësuesi parashikon aktivitete muzikore.

Pra, **liria e planifikimit të planit vjetor ju përket JUVE.**

| Tematikat                                    | Shpërndarja e përmbajtjes lëndore        |  |  |
|--|--|--|--|
|  | Shtator – Dhjetor<br>13 orë              | Janar – Mars<br>12 orë                             | Prill – Qershor<br>10 orë                |
| <b>Gjuha dhe komunikimi muzikor (8 orë)</b>  | 1. Tingulli dhe burimi i tij             | 1. Ritmi me 2 dhe 3 goditje - theksi muzikor       | 1. Ritmi me katër goditje theksi muzikor |
|  | 2. Cilësitë e tingujve                   | 2. Krijojmë me ritmet me 2 - 3 goditje             | 2. Krijojmë ritmin me 4 goditje          |
| <b>Teknika dhe procese muzikore (22 orë)</b> | 3. Kënga: “Himni i Flamurit”             | 3. Kënga: “O i vogël o partizan”                   | 3. Kënga: “Nëna Shqipëri”                |
|  | 4. Kënga: “Kur shikoj një yll”           | 4. Kënga: “Bleta dhe flutura”                      | 4. “Erdhi një dallëndyshe”               |
|  | 5. Kënga: “Një, dy, tre sonte erdhëm ne” | 6. Kënga: “Njëshi dhe zeroja”                      | 5. Kënga: “Sa herë vjen qershori”        |
|  | 6. Ndërtojmë instrumente Orf             |  |  |
| <b>Historia, muzika dhe shoqëria (5 orë)</b> | 7. Muzika dhe emocioni                   | 7. Ritmi, shpejtësia, ngjyrimi, dinamika në muzikë | 6. Vallëzojmë sipas ritmit               |
|  | 8. Muzika nëpërmjet arteve të tjera      |  |  |
| 35 <sup>1</sup> orë                          |  |  |  |

<sup>1</sup> Planifikimi i temave mësimore bëhet nga vetë mësuesi. Disa këngë apo veprimtari muzikore mund të zgjasin edhe 2 orë.

## PLANIFIKIMI <sup>1</sup>, PERIUDHA: SHTATOR – DHJETOR

### REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

#### Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

1. Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike.
2. Kupton mesazhet nëpërmjet simboleve muzikore që u drejtohen.
3. Shpjegon në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve dhe formave artistike.
4. Komunikon në mënyrë të pavarur dhe krijuese mundësitë e të shprehurit në muzikë.

#### Kompetenca e të menduarit

1. Mendon në mënyrë krijuese në situata të ndryshme të të menduarit.
2. Përpunon njohuritë në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.
3. Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.
4. Demonstron realizimin e një krijimi/interpretimi në një veprimtari muzikore.

#### Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

1. Përdor mjetet për të realizuar një krijim muzikor.
2. Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim muzikor.
3. Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën muzikore.

#### Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

1. Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.

#### Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

1. Zhvillon besimin te vetja gjatë krijimit/performimit/vlerësimit muzikor respekton punën e vet dhe të tjerëve.
2. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

#### Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

1. Diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.

#### Kompetenca digjitale

1. Përdor mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

| Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të lëndës   |   |   |
|---|---|---|
| <i>Krijimi muzikor</i>  | <i>Interpretimi muzikor</i>   | <i>Vlerësimi muzikor</i>  |
| <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>krijon me modele ritmike me dy, tri dhe katër goditje;</li> <li>krijon modele ritmike me mjete trupore, me zë dhe simbole, duke vënë në pah theksin e fortë gjatë ritmizimit të tyre;</li> <li>krijon simbole grafike për këto ritme;</li> <li>karakterin e pjesëve muzikore kur luhen ose këndohen; improvizon mbi një këngë apo melodi sipas ritmit apo karakterit të melodisë.</li> </ul> | <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>interpretin këngë dhe lojëra muzikore në kohët 2, 3, 4 kohë; interpretin këngë apo lojëra muzikore, duke demonstruar kuptimin shpejtësisë së muzikës sipas terminologjisë së mësuar; luan ksilofon sipas alfabetit muzikor;</li> <li>këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;</li> <li>interpretin këngë për fëmijë duke iu përshtatur teksteve të këngës; interpretin këngët me ndjenjë dhe emocion;</li> <li>luan me instrumentet ORF apo me mjete trupore sipas simbolikës së përdorur në ritme me dy, tre dhe katër goditje;</li> <li>performon/interpretin këngët në festat e klasës apo të shkollës;</li> <li>komunikon mendimin e vet rreth këngës së interpretuar; interpretin dhe reflekton emocionet që i krijon një këngë, apo pjesë muzikore gjatë interpretimit;</li> <li>vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve.</li> </ul> | <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>shpjegon ndryshimin ritmik të këngët me dy, tri dhe katër goditje;</li> <li>bën lidhje të shembuj të ndryshueshmërisë së shpejtësisë së muzikës nëpërmjet shembujve muzikore që dëgjon, duke shpjeguar emocionet që i krijojnë;</li> <li>shpreh emocionet e veta për këngët që këndon;</li> <li>përdor elementet e gjuhës muzikore gjatë shpjegimit emocional;</li> <li>bën lidhje ndërmjet asaj që ndien dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore;</li> <li>shpreh qartë mendimin e vet emocional për këngët apo veprat muzikore, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore gjatë argumentimit të ndjenjës emocionale që i shkakton muzika;</li> <li>përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton mendimin e shokëve;</li> <li>respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera; merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës;</li> <li>përrjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.</li> </ul> |

<sup>2</sup> **GJ&KM** - Gjuha dhe komunikimi muzikor; **T&P** - Teknika dhe procese; **HM&SH** - Historia, muzika dhe shoqëria

| Nr. | Tematika <sup>2</sup> | Temat mësimore              | Situata e të nxënit   | Burime dhe materiale   |
|-----|-----------------------|-----------------------------|---|--|
| 1   | <i>T&amp;P</i>        | Kënga: “Himni i Flamurit”   | <b>Situata e të nxënit: Jam krenar se jam shqiptar</b><br>Nxënësit/et nxiten të shprehen me fjalët e tyre rreth identitetit të vetë si shqiptar dhe të gjejnë fjalët më të bukura për Shqipërinë.   | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.             |
| 2   | <i>GJ&amp;KM</i>      | Tingulli dhe burimi i tij   | <b>Situata: Mjedisi ynë</b><br>Në mjedisin e klasës dëgjohen ose improvizohen tinguj të ndryshëm të prodhuar nga vetë nxënësit me objekte të ndryshme apo me zërin e tyre. Nxiten të shpjegojnë si është tingulli për veshin e tyre.  | - Cd;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.                       |
| 3   | <i>GJ&amp;KM</i>      | Cilësitë e tingujve         | <b>Situata: Kuptimi për tingullin</b><br>Dëgjohen disa tingujt nga magnetofoni dhe përcaktohen karakteristikën e tingullit që krijohet: <i>i ulët - i lartë; i gjatë - i shkurtër apo i fortë - i butë.</i>   | - Cd me shembuj për dëgjim;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit. |
| 4   | <i>T&amp;P</i>        | Kënga: “Kur shikoj një yll” | <b>Situata: Imagjinata dhe bota reale</b><br>Nxiten nxënësit të flasin rreth imagjinatës por edhe botës reale që ata shikojnë çdo ditë, duke krahasuar ndonjëherë botën me objekte, shpendë apo njerëzit më të dashur që ata kanë. Janë sytë dhe mendja që na bëjnë të shohim dhe imagjinojmë gjithçka. | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.             |
| 5   | <i>HM&amp;SH</i>      | Muzika dhe emocioni         | <b>Situata: Unë kam emocion nga...</b><br>Dëgjohen fragmentet muzikore “Kur kthehem nga shëtitja”, “Nina-Nana” nga Franc Shubert, “Sinfonia e kafshëve” dhe ngjyros me ngjyrën që ti mendon se shkon me muzikën.  | - Cd me shembuj muzikore;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- Fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.   |

|   |                  |                                       |   |  |
|---|------------------|---------------------------------------|---|--|
| 6 | <i>T&amp;P</i>   | Kënga: “Një, dy, tre sonte erdhëm ne” | <b>Situata: Shoku im emigrant</b><br>Nxiten nxënësit të tregojnë një ngjarje ose histori lidhur me një shok të vetin emigrant që vjen me pushime në Shqipëri. Çfarë shpreh ai/ajo për vendin e tij Shqipërinë? Diskutohet në klasë.                                   | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- Fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.           |
| 7 | <i>T&amp;P</i>   | Ndërtojmë instrumente Orf             | <b>Unë di të krijoj</b><br>Nxënësit vëzhgojnë instrumentin muzikor të parapëlqyer dhe përcaktojnë materialet me të cilat do të punojnë për ndërtimin e tij. Shpjegojnë përbërjen dhe tingullin që lëshojnë instrumentet muzikore që kanë ndërtuar.                    | - materiale të ndryshme për ndërtimin e instrumentit/eve;<br>- Fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.    |
| 8 | <i>HM&amp;SH</i> | Muzika nëpërmjet arteve të tjera      | <b>Situata: Unë përjetoj muzikën dhe shprehem edhe përmes...</b><br>Dëgjohen fragmentet muzikore nga veprat: “ <i>Vallëzimi i tarantelës</i> ” - <i>Rosini</i> ; “ <i>Ajri</i> ” <i>Bahut</i> dhe shpreh emocionet e tua përmes arteve të tjera: ese, poezi, vizatim. | - Cd me shembuj muzikore;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- Fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit. |
| 9 | <i>T&amp;P</i>   | Koncert                               |   | - <b>Cd</b>  |

#### Metodologjia e mësimdhënies për çdo orë mësimore







Çdo orë mësimore ndërtohen duke u bazuar në strukturën ERR dhe teknikat e mësimdhënies. Gjithashtu, muzika si lëndë praktike mbështet dhe zhvillon shumë teknikat bashkëvepruese, interaktive, gjithëpërfshirëse si: improvizimi, bashkëbisedimi, punë vetëm dhe në grup, ose këndimi solo dhe në grup.

#### Vlerësimi

Demonstrim i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet;  
Demonstrim i rezultateve të arritura të interpretimit të këngës dhe diskutimit ndaj melodisë dhe tekstit.

Demonstrim i rezultateve të arritura nëpërmjet detyrave të kryera dhe vendosura në portofol.

## PLANIFIKIMI DITOR – PERIUDHA E PARË

| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|--|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Kënga: “Himni Kombëtar”  |               | <b>Situata: Vendlindja ime - Shqipëria</b><br>Nxënësit/et nxiten të shprehen me fjalët e tyre rreth identitetit të vet si shqiptar dhe të gjejnë fjalët më të bukura për Shqipërinë.  |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;</li><li>- shpreh emocionet e veta për këngën himn;</li><li>- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.</li></ul>  |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- melodia e këngës;</li><li>- teksti i këngës;</li><li>- rregullat e këndimit;</li><li>- kënga himn.</li></ul>                      |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me këngën;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia, gjuha shqipe dhe edukim për shoqërinë.</li></ul><br><b>Lidhja me temat ndërkurrikulare:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- identiteti im.</li></ul> |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>   |               |   |           |
| <b><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></b><br>Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të shprehin emocionet që ndiejnë kur flasin për vendlindjen e tyre. Ata nxiten të shprehen me fjalët e tyre rreth identitetit të vet si shqiptar dhe të gjejnë fjalët më të bukura për Shqipërinë. Më pas, ata nxiten të vizatojnë në shtëpi pamje ose një simbol që përfaqëson Shqipërinë.   |               |   |           |
| <b>HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</b>   |               |   |           |
| <b><i>Ndërtimi i njohurive të reja</i></b><br> <b>Dëgjohet</b> kënga “Himni i flamurit” dhe <b>vazhdohet</b> puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"><li>• këndohet kënga varg pas vargu;</li><li>• përsëriten vargjet herë pas here;</li><li>• këndohet strofa;</li><li>• këndohet strofa dhe refreni;</li><li>• përsëritet kënga nga fillimi në fund;</li><li>• interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;</li><li>• këndohet kënga vetëm dhe në grup.</li></ul> |               |   |           |
|  |               |   |           |

**Teksti i këngës: Himni i flamurit****- I -**

Rreth flamurit të përbashkuar  
 Me një dëshir' me një qëllim,  
 Të gjith' atij duk' iu betuar  
 Të lidhim besën për shpëtim.  
 Prej lufte veç ay largohet  
 Që është lindur tradhëtor,  
 Kush është burrë nuk frikohet,  
 Por vdes, por vdes si një dëshmor!


**- II -**

Në dorë armët do t'i mbajmë  
 Të mbrojmë atdhenë më çdo kënd,  
 Të drejtat tona ne s'i ndajmë,  
 Këtu armiqtë s'kanë vend.

Se Zoti vet e tha me gojë  
 Që kombe shuhen përmbi dhe,  
 Po Shqipëria do të rrojë,  
 Për të, për të luftojmë ne!

**- III -**

O flamur, flamur, shenj' e shenjtë,  
 Te ty betohemi këtu,  
 Për Shqipërin' atdhen' e shtrenjtë,  
 Për nder' edhe lavdimn' e tu.  
 vTrim, burrë quhet dhe nderohet  
 Atdheut kush iu bë theror;  
 Për jet' ay do të kujtohet  
 Mbi dhe, nën dhe si një shenjtor!



Rreth fla mu - rit të për bash - ku - ar, me një dë -

shir' me një që - llim, të gjith' a - tij duk' iu be -

tu - ar të li - dhim be - sën për shpë - tim. Prej

luf te veç a - y lar - go - het që është lin - dur tra - dhë -

tor, kush është bu - rrë nuk fri - ko - het por





vdes, por vdes si një dësh - mor! Por vdes, po vdes si një dësh - mor!

■ **Gjatë mësimimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e **ritmit**, të **intonacionit** dhe të **interpretimit** të këngës.






**► Vlerësimi**





Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultateve e arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (Shqipëria, kënga himn etj.);
- këndimin me emocione të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).
- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|--|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi muzikor<br><b>Tema mësimore:</b> Tingulli dhe burimi i tij   |               | <b>Situata: Mjedisi ynë</b><br>Në mjedisin e klasës dëgjohej ose improvizoheshen tinguj të ndryshëm të prodhuar nga vetë nxënësit me objekte të ndryshme apo me zërin e tyre. Nxiten të shpjegojnë si është tingulli për veshin e tyre.   |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- shpjegon burime të tingujve që dëgjon në mjedisin përreth;</li><li>- imiton tingullin që dëgjon në mjedisin përreth;</li><li>- emërton tingujt që dëgjon sipas karakteristikave të tyre.</li></ul>   |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- tingull;</li><li>- zhurmë;</li><li>- këndshëm;</li><li>- pakëndshëm;</li><li>- dridhje;</li><li>- tinguj natyrorë;</li><li>- tinguj njerëzore;</li><li>- tinguj muzikore.</li></ul> |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me shembuj;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Dituria e natyrës</li></ul>  |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mund të dëgjojnë në mjedisin e klasës tinguj të ndryshëm të prodhuar nga vetë nxënësit me objekte të ndryshme apo me zërin e tyre. Nxiten të shpjegojnë si është tingulli për veshin e tyre.   |               |   |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br><b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të improvizojnë apo prodhojnë vetë tinguj që ata dinë, duke u kërkuar atyre të thonë çfarë karakteristike ka tingulli që sapo krijuan. Është i këndshëm apo i pakëndshëm për veshin.<br><b>Hapi II</b> U kërkohej nxënësve të kryejnë sipas udhëzimeve të mësuesit disa veprime: të përplasin topin në dysheme, të godasin me çekiç tavolinën, të fryjnë një letër plastike, të mundohen të krijojnë jehonën.<br><b>Hapi III</b> Vazhdohej më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të plotësojnë një ushtrim dhe të përcaktojnë cila prej tyre lëshon tingull të këndshëm apo të pakëndshëm. |               |   |           |
| <b>Vlerësimi</b><br>Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të <i>rezultateve të arritura</i> në: <ul style="list-style-type: none"><li>- shpjegimin e burimeve të tingujve që dëgjon në mjedisin përreth;</li><li>- imitimin e tingujve që dëgjon në mjedisin përreth;</li><li>- imitimin e tingujve që dëgjon sipas karakteristikave të tyre.</li></ul><br><b>Detyra:</b> Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.  |               |   |           |



| Fusha: Arte   | Lënda: Muzikë | Shkalla: II  | Klasa: IV |
|---|---------------|--|-----------|
| <b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi muzikor<br><b>Tema mësimore:</b> Cilësitë e tingullit   |               | <b>Situata: Kuptimi për tingullin</b><br>Dëgjohen disa tingujt nga magnetofoni dhe përcaktohen karakteristikat e tingullit që krijohet: <i>i ulët - i lartë; i gjatë - i shkurtër apo i fortë - i butë.</i>  |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dallon cilësitë e tingullit <i>ulët - i lartë; i gjatë - i shkurtër apo i fortë - i butë;</i></li><li>- shpjegon cilësitë e tingullit <i>ulët - i lartë; i gjatë - i shkurtër apo i fortë - i butë;</i></li><li>- shpjegon cilësitë e tingullit duke i demonstruar ato;</li><li>- <i>lartësia gjatësia, intensiteti;</i></li><li>- vizaton simbolikisht cilësitë e tingullit.</li></ul>   |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- i ulët/i lartë;</li><li>- i gjatë/i shkurtër;</li><li>- i fortë/i butë;</li><li>- lartësia;</li><li>- gjatësia;</li><li>- intensiteti.</li></ul> |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me shembuj;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Dituria e natyrës</li><li>- Arti pamor</li></ul>  |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |  |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku vendosen për dëgjim disa tingujt nga magnetofoni dhe u kërkohet nxënësve të përcaktojnë karakteristikën e tingullit që krijohet: <i>i ulët - i lartë; i gjatë - i shkurtër apo i fortë - i butë.</i>  |               |  |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br><b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të gjejnë në fjalët me dy rrokje të shkruara në tabelë theksin e fjalës. U kërkohet nxënësve të gjejnë ku bie theksi te fjalët me dy rrokje. Shkruhen fjalë të ndryshme...<br><b>Hapi II</b> U kërkohet nxënësve të ushtrohen me kujdes në ushtimin e zhvilluar nga mësuesi, duke përdorur instrumente me goditje ose mjetet trupore. Sa goditje dëgjohen?<br><b>Hapi III</b> Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur nxënësit të plotësojnë fjalët e dhëna në kuicin e krijuar nga mësimdhënësi, por edhe duke vëzhguar figurat. |               |  |           |
|  <b>Vlerësimi</b><br>Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura në: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikimin e cilësive të tingullit <i>ulët - i lartë; i gjatë - i shkurtër apo i fortë - i butë;</i></li><li>- shpjegimin e cilësive të tingullit duke demonstruar ato: <i>lartësia, gjatësia, intensiteti.</i></li><li>- vizatimin simbolikisht të cilësive të tingullit.</li></ul><br><b>Detyra:</b> Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.                                      |               |  |           |

| Fusha: Arte   | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|---|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Kënga: “Kur shikoj një yll”   |               | <b>Situata: Imagjinata dhe bota reale</b><br>Nxiten nxënësit të flasin rreth imagjinatës por edhe botës reale që ata shikojnë çdo ditë, duke krahasuar ndonjëherë botën me objekte, shpendë apo njerëzit më të dashur që ata kanë. Janë sytë dhe mendja që na bëjnë të shohim dhe imagjinojmë gjithçka. |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;</li><li>- shpreh emocionet e veta për stinët dhe tekstin e këngës;</li><li>- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.</li></ul>   |               | <input checked="" type="checkbox"/> <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- melodia e këngës;</li><li>- teksti i këngës;</li><li>- rregullat e këndimit.</li></ul>  |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- me këngën;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Shkencat natyrore: dituria e natyrës.</li></ul>  |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit të cilët i nxisim të flasin rreth imagjinatës por edhe botës reale që ata shikojnë çdo ditë, duke krahasuar ndonjëherë botën me objekte, shpendë apo njerëzit më të dashur që ata kanë. Janë sytë dhe mendja që na bëjnë të shohim dhe imagjinojmë gjithçka.  |               |   |           |
| <div><h2>HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</h2><p><i>Ndërtimi i njohurive të reja</i></p><div> <b>Dëgjohet</b> kënga “Kur shikoj një yll” dhe <b>vazhdohet</b> puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:</div><ul style="list-style-type: none"><li>• këndohet kënga varg pas vargu;</li><li>• përsëriten vargjet herë pas here;</li><li>• këndohet strofa;</li><li>• këndohet strofa dhe refreni;</li><li>• përsëritet kënga nga fillimi në fund;</li><li>• interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;</li><li>• këndohet kënga vetëm dhe në grup.</li></ul></div> |               |   |           |

### Teksti i këngës: “Kur shikoj një yll”

#### - I -

Kur një yll shikoj në mbrëmje,  
edhe syri ta tregoj,  
ti më the buzëqeshur,  
atë yll dhe un' shikoj.  
Kur shoh zogun që në mbrëmje,  
për të fjetur kërkon vend,  
ti më thua buzëqeshur,  
un' e shoh në syrin tënd.  
Unë zogun e shikoj,  
e shikoj në syrin tënd,  
yllin natën që ndriçon,  
edhe ty yjet ta tregojn'.

#### - Refreni -

Çdo gjë që shikoj në botë,  
e ke pare edhe ti,  
se të dy ne i shikojmë,  
dhe me zemër dhe me sy.

Ato që shikoj në botë,  
ikin larg, ikin larg si kujtim,  
dhe un' shoh me syrin tënd,  
dhe ti sheh me syrin tim.

#### - II -

Kur shoh n' mbrëmje xixëllonjën,  
që nis rrugën për shtegtar,  
ti më thua buzëqeshur,  
edhe un' atë kam parë.  
Xixëllonjën e shikoj,  
e shikoj dhe në syrin tënd,  
yllin natën që ndriçon,  
edhe ty yjet ta tregojn'.

#### - Refreni -

Çdo gjë që shikoj në botë...



## Allegretto

Muzika: Ina Osmanlli

Ku një yll' shi - koj në mbrë - mje e - dhe ty vij'

ta tre - goj Ti më thu - a bu - zë - qe - shur

a - të yll dhe un' shi - koj Kur shoh zo - gun që në mbrë -

mje për të fje - tur kër - kon vend Ti më thu - a

bu - zë - qe - shur Un' e shoh në sy - rin tënd

U - në zo - gun e shi - koj e shi - koj dhe në sy - rin tënd

Y - llin na - tën që ndri - çon e - dhe ty vij e ta tre - goj

bu - zë - qe - shur Un' e shoh në sy - rin tënd

U - në zo - gun e shi - koj e shi - koj dhe në sy - rin tënd

Y - llin na - tën që ndri - çon e - dhe ty vij e ta tre - goj

Çdo gjë që shi - koj në bo - të e ke pa - rë e - dhe ti

Se të dy ne i shi - koj - më dhe me ze - mër dhe me sy

A - to që shi-koj në bo - të vij t'i lë vij t'i lë

si kuj - ti - im se un' shoh me sy - rin tënd Dhe ti sheh me

sy - rin tim. e ti sheh me sy - rin tim

e ti sheh me sy - rin tim

■ **Gjatë mësimimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.

► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (ëndërrat, yjet);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

**Shënime specifike:**

---

---

---

---

---

---

---




---

---

---

---

---

| Fusha: Arte   | Lënda: Muzikë | Shkalla: II  | Klasa: IV |
|---|---------------|--|-----------|
| <b>Tematika:</b> Historia, muzika dhe shoqëria<br><br><b>Tema mësimore:</b> Muzika dhe emocioni   |               | <b>Situata: Unë kam emocion nga...</b><br>Dëgjohen fragmentet muzikore “Kur kthehem nga shëtitja”, “Nina-Nana” nga Franc Shubert, “Sinfonia e kafshëve” dhe ngjyros me ngjyrën që ti mendon se shkon me muzikën. |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dëgjon fragmente të ndryshme muzikore: “Kur kthehem nga shëtitja”, “Nina-Nana” nga Franc Shubert, “Sinfonia e kafshëve” me vëmendje;</li><li>- përshkruan përjetimin emocional që merr nga muzika që dëgjon;</li><li>- argumenton emocionet që i krijon muzika gjatë dëgjimit të saj, duke dhënë gjykimin e vet pse i pëlqen.</li></ul>   |               | <input checked="" type="checkbox"/> <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- muzika;</li><li>- parapëlqim;</li><li>- përjetim emocional.</li></ul>  |           |
| <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me këngën;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Shkencat shoqërore dhe mjedisi, historia, gjuha shqipe dhe edukim për shoqërinë.</li></ul>  |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>   |               |  |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një dëgjim të shkurtër nga një fragment muzikor 2-3 minuta ku nxënësit/et dëgjojnë fragmentet muzikore “Kur kthehem nga shëtitja”, “Nina-Nana” nga Franc Shubert, “Sinfonia e kafshëve” dhe ngjyros me ngjyrën që ti mendon se shkon me muzikën.   |               |  |           |
| <b>HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</b>  |               |  |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br> <b>Dëgjohen</b> fragmente të ndryshme muzikore “Kur kthehem nga shëtitja”, “Nina-Nana” nga Franc Shubert, “Sinfonia e kafshëve” dhe <b>vazhdohet</b> puna sipas hapave të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"><li>- U kërkohet nxënësve të përshkruajnë emocionet që të jep ajo. <i>Pse të pëlqen muzika që dëgjove?</i></li><li>- U kërkohet nxënësve të shpjegojnë dhe argumentojnë me fjalë të thjeshta muzikën që dëgjuan.</li></ul>                                    |               |  |           |
| <b>► Vlerësimi</b><br>Vlerësimi i nxënësit do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura në: <ul style="list-style-type: none"><li>- dëgjimin me vëmendje të fragmenteve muzikore dhe emocionin që përjeton prej saj;</li><li>- përshkrimin emocional që merr nga muzika duke veçuar pjesën që i pëlqeu më shumë;</li><li>- qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth muzikës që dëgjon me fjalë të thjeshta dhe duke shpjeguar pse e pëlqen atë.</li></ul> <ul style="list-style-type: none"><li>- <b>Detyra:</b> Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.</li></ul> |               |  |           |

| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II  | Klasa: IV |
|--|---------------|--|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Kënga: “Një, dy, tre sonte erdhëm ne”  |               | <b>Situata: Shoku im emigrant</b><br>Nxiten nxënësit të tregojnë një ngjarje ose histori lidhur me një shok të vetin emigrant që vjen me pushime në Shqipëri. Çfarë shpreh ai/ajo për vendin e tij Shqipërinë?<br>Diskutohet në klasë. |           |
| <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;</li> <li>- shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës;</li> <li>- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.</li> </ul> |               | <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- melodia e këngës;</li> <li>- teksti i këngës;</li> <li>- rregullat e këndimit.</li> </ul>   |           |
| <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cd me këngën;</li> <li>- materiale të parapërgatitura;</li> <li>- fletorja e nxënësit;</li> <li>- teksti i mësuesit.</li> </ul>   |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjuha shqipe dhe letërsia;</li> <li>- Njohuri për shoqërinë.</li> </ul>  |           |



### Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*

Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të flasin rreth emigrimit, tregojnë një ngjarje ose histori lidhur me një shok të vetin emigrant që vjen me pushime në Shqipëri. Çfarë shpreh ai/ajo për vendin e tij Shqipërinë? Diskutohet në klasë.

#### *Ndërtimi i njohurive të reja*

### HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:



**Dëgjohet** kënga “Një, dy, tre sonte erdhëm ne” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- kënga vetëm dhe në grup.





### Teksti i këngës: “Një, dy, tre sonte erdhëm ne”

#### - I -

Tokën shoh nën re  
fluturoj me mall  
un' po kthehem në atdhe  
se jam lindur larg.

Allegretto

Muzika: Edmond Zhulali  
Teksti: Agim Doçi



Tok - ën shoh në - në re flu - tu - roj me mall

#### - II -

Erdha me gëzim  
në atdheun tim  
se do flas në shqip  
siç ke folur ti Naim.



un' po kthe - hem në At - dhe se jam lin - dur larg.

#### - Refreni -

Një, dy, tre  
sonte erdhëm ne  
mami un' edhe babi im  
sa e lumtur jam n' atdhe  
ku un' shoh të bukrin vendin tim.



Er - dha me gë - zim në At - dhe un tim



se do flas në shqip siç ke fo - lur ti Na - im

#### - III -

Rrugët mbushur plot  
qenkan plot ndriçim  
nuk e njihja dot  
sot qytetin tim.



1 2 3 bash - kë er - dhëm ne ma - mi un'



e - dhe ba - bi im' sa e lum - tur jam n'At - dhe

#### - IV -

Zemra më troket  
dhe një zë më flet  
me shumë dashuri  
sa mir' jam në Shqipëri.



ku un' shoh të buk - rin ven - din tim.

#### - Refreni -

Një, dy, tre...



tim.

■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit*, të *intonacionit* dhe të *interpretimit* të këngës.


#### ► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (shoqëria/miqësia etj.);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.



| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|--|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika & procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Ndërtojmë instrumente<br>Orf: <i>shkopinjtë, tamburi, zilka</i>  |               | <b>Situata: Unë di të krijoj</b><br>Nxënësit vëzhgojnë instrumentin muzikor të parapëlqyer dhe përcaktojnë materialet me të cilat do të punojnë për ndërtimin e tij. Shpjegojnë përbërjen dhe tingullin që lëshojnë instrumentet muzikore që kanë ndërtuar. |           |
| <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- ndërton me mjete rrethore instrumentet muzikore orf me goditje, vetëm ose me të tjerët;</li><li>- kupton rëndësinë e përdorimit të veglave me goditje;</li><li>- shoqëron me veglat e krijuara këngë të ndryshme.</li></ul>  |               | <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Instrument me goditje;</li><li>- shkopinjtë;</li><li>- tambura;</li><li>- zilka.</li></ul>  |           |
| <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- materiale të riciklueshme;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Teknologjia</li></ul>  |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon duke vendosur disa foto dhe materiale të riciklueshme për krijimin e instrumenteve muzikore dhe pyeten nxënësit a njohin ndonjë prej tyre? Si quhen? Çfarë dimë për to? Nga çfarë materiali përbëhen? Çfarë karakteristikash ka glockenshpili?   |               |   |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br><br><b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të vëzhgojnë figurat e instrumenteve që ata do të ndërtojnë në fletoren e tyre dhe të lidhin me shigjetë emrin me instrumentin përkatës.<br><br><b>Hapi II</b> U kërkohet nxënësve të veçojnë instrumentin që duan të ndërtojnë.<br><br><b>Hapi III</b> Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur materialet e grumbulluara dhe udhëzohen për hapat që do të ndjekin për të ndërtuar instrumentin. Mësuesi/ja u rri pranë atyre duke i mbështetur dhe duke u treguar mënyrën se si duhet të punojnë. Ata: <ul style="list-style-type: none"><li>- ndahen në grupe për ndërtimin e instrumentit me goditje (shkopinj, zilka, tambur);</li><li>- ndjekin udhëzimet për ndërtimin e tij;</li><li>- diskutojnë me njëri-tjetrin për instrumentin muzikor;</li><li>- provojnë tingëllimin e instrumentit me goditje dhe i shpjegojnë ato;</li><li>- këngët apo këngët-lojë me instrumente me goditje.</li></ul> |               |   |           |

**Hapi IV** Nxënësit/et diskutojnë efektet që krijojnë instrumenti me goditje, duke diskutuar rreth ndryshimit të tingëllimit dhe arsyt e këtij ndryshimi, si: *materiali, madhësia etj.*

► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultatetve të arritura* në:

- përgatitjen dhe ndërtimin e instrumentit me goditje;
  - ndjekjen e udhëzimeve për ndërtimin e tij;
  - shoqërimin e këngëve vetëm dhe në grup me instrumentet me goditje që u krijuan.
- **Detyra:** Punët (instrumenti i ndërtuar) nga nxënësit ruhet në dosjen e tyre personale.

### Informacion për mësuesin

Disa nga instrumentet me goditje që mund t'ju sugjerohen nxënësve për ndërtimin e tyre.



### Shënime specifike:

---

---

---



---

---

---

---

---

| Fusha: Arte   | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|---|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Historia, muzika dhe shoqëria<br><br><b>Tema mësimore:</b> Muzika nëpërmjet arteve të tjera  |               | <b>Situata: Unë përjetoj muzikën dhe shprehem edhe përmes...</b><br>Dëgjohen fragmentet muzikore nga veprat: “Vallëzimi i tarantelës” - Rosini; “Ajri” Bahut dhe nxiten nxënësit të shprehin emocionet edhe nëpërmjet arteve të tjera: ese, poezi, vizatim. |           |
| <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- dëgjon fragmente të ndryshme muzikore, duke përjetuar emocionet që i krijon muzika;</li><li>- identifikon karakterin e muzikës që dëgjon dhe i shpjegon ato;</li><li>- reflekton emocionet që i krijon muzika gjatë dëgjimit të saj, duke shprehur emocionet nëpërmjet arteve të tjera që zgjedh.</li></ul>   |               | <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- karakteri i muzikës;</li><li>- përjetim emocional.</li></ul>  |           |
| <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me këngën;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Gjuha shqipe;</li><li>- kërcimi;</li><li>- arti pamor.</li></ul>   |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një dëgjim të shkurtër nga një fragment muzikor 3-4 minuta ku nxënësit dëgjojnë muzikën. Dëgjohen fragmentet muzikore nga veprat: “Vallëzimi i tarantelës” - Rosini; “Ajri” Bahut dhe nxiten nxënësit të shprehin emocionet edhe nëpërmjet arteve të tjera: ese, poezi, vizatim.   |               |   |           |
| <div><h2>HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</h2><p><b>Ndërtimi i njohurive të reja</b></p><b>Dëgjohen fragmentet muzikore nga veprat: “Vallëzimi i tarantelës” - Rosini; “Ajri” Bahut dhe vazhdohet puna sipas hapave të mëposhtëm:</b><ul style="list-style-type: none"><li>• U kërkohet nxënësve të përshkruajnë emocionet që u jep muzika që dëgjuan. Pse të pëlqen muzika që dëgjoje?</li><li>• U kërkohet nxënësve të shpjegojnë me fjalë të thjeshta si do ta shprehnin emocionin nëpërmjet një arti tjetër?</li><li>• Nxiten nxënësit të shprehin emocionet edhe nëpërmjet arteve të tjera: ese, poezi, vizatim.</li></ul></div> |               |   |           |

### ► Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi muzikën dhe përjetimin që merr prej saj;
- dallimin e karakterit të muzikës që dëgjon;
- qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth muzikës që dëgjon me fjalë të thjeshta dhe duke shprehur emocionet nëpërmjet arteve të tjera që zgjedh.

- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

### Informacion për mësuesin

**Xhoakino Rosini** (1792-1868) lindi në Pezaro të Italisë dhe edukimin fillestar muzikor e mori nga prindërit. Që në moshë të re punoi si drejtues muzikor i grupeve operistike shëtitëse, duke studiuar njëkohësisht me shumë vëmendje gjininë e operës, rolin dhe vendin që zinte këngëtari në të. Ai studioi dhe këngët popullore italiane, të papërpunuara, nga krahina të ndryshme të Italisë. Figura e Rosinit zë një vend mjaft të rëndësishëm në historinë e muzikës italiane. Disa nga veprat e tij operistike janë: “Tankredi”, sipas tragjedisë me të njëjtin titull të Volterit, “Hirushja”, “Laraska vjedhacake”, “Semiramida” dhe “Berberi i Seviljes”, e cila u bë një nga operat më të famshme në të gjithë Evropën. Opera “Vilhem Teli” shënoi fundin e krijimtarisë së tij.



*Xhoakino Rosini*



*Johan Sebastian Bah*

**Johan Sebastian Bah** (Johann Sebastian Bach) (1685-1750) lindi në qytetin gjerman të Ajzenahut, në një familje me tradita shumë të forta muzikore. Pjesëmarrja në korin e kishës gjatë fëmijërisë i ngjalli dëshirën për të studiuar dhe kompozuar muzikë.

Veprimtarinë muzikore e nisi si violinist në oborrin e dukës së Vajmarit, ku shkroi disa vepra të ndikuara nga muzika italiane. Kantatat, oratoriot, meshat dhe lloje të tjera të muzikës së Bahut, bënë që ai të njihej si kompozitor fetar. “Koncertet Branderburgeze” janë dëshmi e qartë e trajtimit që ai i bëri koncertit solo, koncertit grosso dhe koncertit për orkestër, ku e veçanta është shkrirja e grupit të solistëve dhe orkestrës. Mjeshtëria e tij muzikore u duk edhe në zhvillimin e polifonisë, e cila bën pjesë në çdo vepër të tij, qoftë vokale, qoftë instrumentale.

Me fugën, Bahu arriti kulmin e krijimtarisë së tij dhe paralajmëroi simfonizimin e shekullit XVIII.

100 vjet më vonë, atëherë kur arti muzikor pati një zhvillim të rëndësishëm, muzikantët e periudhës së romantizmit zbuluan vlerat e tij të padiskutueshme si krijues, pedagog dhe teoricien.

## PLANIFIKIMI 1, PERIUDHA: JANAR – MARS

### REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

#### Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

1. Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike.
2. Kupton mesazhet nëpërmjet simboleve muzikore që u drejtohet.
3. Shpjegon në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve dhe formave artistike.
4. Komunikon në mënyrë të pavarur dhe krijuese mundësitë e të shprehurit në muzikë.

#### Kompetenca e të menduarit

1. Mendon në mënyrë krijuese në situata të ndryshme të të menduarit.
1. Përpunon njohuritë në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.
2. Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.
3. Demonstron realizimin e një krijimi/interpretimi në një veprimtari muzikore.

#### Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

1. Përdor mjetet për të realizuar një krijim muzikor.
2. Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim muzikor.
3. Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën muzikore.

#### Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

1. Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.

#### Kompetenca personale

1. Zhvillon besimin te vetja gjatë krijimit/performimit/vlerësimit muzikor respekton punën e vet dhe të të tjerëve.
2. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

#### Kompetenca qytetare

1. Diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.

#### Kompetenca digjitale

1. Përdor mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës   |   |  |
|---|---|--|
| <i>Krijimi muzikor</i>  | <i>Interpretimi muzikor</i>   | <i>Vlerësimi muzikor</i>   |
| <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>krijon me modele ritmike me dy, tri dhe katër goditje;</li> <li>krijon modele ritmike me mjete trupore, me zë dhe simbole, duke vënë në pah theksin e fortë gjatë ritmizimit të tyre;</li> <li>krijon simbole grafike për këto ritme;</li> <li>karakterin e pjesëve muzikore kur luhen ose këndohen; improvizon mbi një këngë apo melodi sipas ritmit apo karakterit të melodisë.</li> </ul> | <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>interpretin këngë dhe lojëra muzikore në kohët 2, 3, 4 kohë; interpretin këngë apo lojëra muzikore, duke demonstruar kuptimin shpejtësisë së muzikës sipas terminologjisë së mësuar; luan ksilofon sipas alfabetit muzikor;</li> <li>këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;</li> <li>interpretin këngë për fëmijë duke iu përshtatur teksteve të këngës; interpretin këngët me ndjenjë dhe emocion;</li> <li>luan me instrumentet ORF apo me mjete trupore sipas simbolikës së përdorur në ritme me dy, tre dhe katër goditje;</li> <li>performon/interpretin këngët në festat e klasës apo të shkollës.</li> <li>komunikon mendimin e vet rreth këngës së interpretuar; interpretin dhe reflekton emocionet që i krijojnë një këngë, apo pjesë muzikore gjatë interpretimit;</li> <li>vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve.</li> </ul> | <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>shpjegon ndryshimin ritmik të këngët me dy, tri dhe katër goditje;</li> <li>bën lidhje të shembujve të ndryshueshmërisë së shpejtësisë së muzikës nëpërmjet shembujve muzikore që dëgjon, duke shpjeguar emocionet që i krijojnë;</li> <li>shpreh emocionet e veta për këngët që këndon;</li> <li>përdor elementet e gjuhës muzikore gjatë shpjegimit emocional;</li> <li>bën lidhje ndërmjet asaj që ndien dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore;</li> <li>shpreh qartë mendimin e vet emocional për këngët apo veprat muzikore, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore gjatë argumentimit të ndjenjës emocionale që i shkakton muzika;</li> <li>përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton mendimin e shokëve;</li> <li>respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera; merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës;</li> <li>përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.</li> </ul> |






<sup>3</sup> **GJ&KM** - Gjuha dhe komunikimi muzikor; **T&P** - Teknika dhe procese; **HM&SH** - Historia, muzika dhe shoqëria







| Nr. | Tematika <sup>3</sup> | Temat mësimore                                  | Situata e të nxënët  | Burime dhe materiale   |
|-----|-----------------------|---|--|--|
| 1   | <i>GJ&amp;KM</i>      | Ritmi me 2 dhe 3 goditje - theksi muzikor       | <b>Situata e të nxënët: Unë dhe ritmi</b><br>U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalë me dy dhe tri rrokje. Më pas, ata rrethojnë rrokjen ku bie theksi dhe ata e shqiptojnë fort.  | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.             |
| 2   | <i>T&amp;P</i>        | Kënga: “O i vogël o partizan”                   | <b>Situata: Dëshmori i qytetit/krahinës time</b><br>Nxiten nxënësit të tregojnë historinë/tregimin e një dëshmori që ata dinë nga qyteti i tyre, duke treguar disa karakteristika të trimërisë së këtij dëshmori.  | - Cd;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.                       |
| 3   | <i>GJ&amp;KM</i>      | Krijojmë me ritmet me 2-3 goditje               | <b>Situata: Krijim im ritmik</b><br>U kërkohet nxënësve të krijojnë modele ritmike me dy dhe tre goditje nëpërmjet simboleve, goditjeve me shuplaka apo me instrumenteve me goditje. Shpjegojnë duke ritmizuar modelin e krijuar.  | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.             |
| 4   | <i>T&amp;P</i>        | Kënga: “Bleta dhe flutura”                      | <b>Situata: Insektet</b><br>Shpërndahen foto të ndryshme ku nxënësit veçojnë insektet, duke shpjeguar çdo njohuri që kanë për to, rëndësinë apo të mirat materiale të tyre.  | - Cd;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.                       |
| 5   | <i>HM&amp;SH</i>      | Ritmi, shpejtësia, ngjyrimi, dinamika në muzikë | <b>Situata: Fjalori muzikor</b><br>Dëgjohen disa fragmente muzikore dhe çdo nxënës duhet të përmbledhë me një fjalë të vetme atë çka dëgjon nga muzika. Rrethohen fjalët <i>ritëm</i> , <i>dinamikë</i> , <i>shpejtësi</i> dhe <i>karakter</i> ; fjalë të cilat do të shpjegohen për të ditur më mirë kuptimin e tyre. | - Cd me shembuj për dëgjim;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- Fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit. |



|  |                |                            |   |  |
|--|----------------|----------------------------|---|--|
| 6  | <i>T&amp;P</i> | Kënga: “Njëshi dhe zeroja” | <b>Situata: Muzika dhe numrat</b><br>Nxënësit nxiten të flasin për numrat dhe lidhjen e matematikës me muzikën. Ata shprehen në mënyra të ndryshme duke rikujtuar edhe një nga karakteristikat e gjatësisë së ritmit me të cilën krijojmë muzikë. | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- Fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit. |
| 7  | <i>T&amp;P</i> | Koncert                    |   | - <b>Cd</b>  |
| <p align="center"><b>Metodologjia e mësimdhënies për çdo orë mësimore</b></p> <p>Çdo orë mësimore ndërtohet duke u bazuar në strukturën ERR dhe teknikat e mësimdhënies. Gjithashtu, muzika si lëndë praktike mbështet dhe zhvillon shumë teknikat bashkëvepruese, interaktive, gjithëpërfshirëse si: improvizimi, bashkëbisedimi, punë vetëm dhe në grup, ose këndimi solo dhe në grup.</p> |                |                            |   |  |
| <p align="center"><b>Vlerësimi</b></p> <p>Demonstrim i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet;<br/>         Demonstrim i rezultateve të arritura të interpretimit të këngës dhe diskutimit ndaj melodisë dhe tekstit.<br/>         Demonstrim i rezultateve të arritura nëpërmjet detyrave të kryera dhe të vendosura në portofol.</p>        |                |                            |   |  |



| Fusha: Arte  |  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|--|--|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi muzikor<br><br><b>Tema mësimore:</b> Ritmi me 2 dhe 3 goditje  |  |               | <b>Situata: Unë dhe ritmi</b><br>U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalë me dy dhe tri rrokje. Më pas ata rrethojnë rrokjen ku bie theksi dhe ata e shqiptojnë fort.  |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- gjen fjalë me dy dhe tri rrokje duke përcaktuar rrokjen ku bie theksi i fortë;</li><li>- improvizon dhe krijon ritme me dy goditje;</li><li>- improvizon modele ritmike me tri goditje me gjatësi të ndryshme;</li><li>- krijon modele me dy dhe tri goditje në fletoren e vet.</li></ul>  |  |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- ritëm me dy goditje;</li><li>- ritëm me tre goditje;</li><li>- modele me gjatësi ritmike të ndryshme me dy goditje.</li></ul> |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me shembuj;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Matematika;</li><li>- Gjuha;</li><li>- Arti pamor.</li></ul>   |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>   |  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi vazhdohet më tej me lojën dhe nxënësit nxiten të pasqyrojnë në mënyrë vizuale apo nëpërmjet simboleve gjatësinë <i>shumë të shkurtër dhe shumë të gjatë</i> . Gjithashtu, ata nxiten të krijojnë modele të ndryshme gjatësish nëpërmjet fjalëve apo simboleve të ndryshme.  |  |               |   |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br><b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të gjejnë fjalë me dy dhe tri rrokje dhe pasi t'i kenë gjetur të ngjyrosin rrokjen e cila theksohet më fort.<br><b>Hapi II</b> U shpjegohet se ashtu si te fjala edhe në muzikë ka theksa të fortë dhe theksa të butë.<br><b>Hapi III</b> Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të krijojnë sipas imagjinatës së tyre simbole që të japin idenë e një - dy goditjeve, <i>për shembull pika e shiut kur bie në tokë</i> .<br><b>Hapi IV</b> U kërkohet nxënësve të krijojnë modele ritmike me 2 dhe 3 goditje dhe ta lexojnë atë. |  |               |   |           |
|  <b>Vlerësimi</b><br>Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të <i>rezultateve të arritura</i> në: <ul style="list-style-type: none"><li>- shpjegimin mbi ritmin me dy dhe tri goditje dhe theksin muzikor;</li><li>- krijimin e modeleve me dy dhe tri goditje nëpërmjet simboleve të ndryshme;</li><li>- shqërimin e modeleve ritmike të krijuara me shuplaka vetëm ose në grup.</li></ul><br><b>Detyra:</b> Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.  |  |               |   |           |

| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II  | Klasa: IV |
|--|---------------|--|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Kënga: “O i vogël o partizan”  |               | <b>Situata: Dëshmori i qytetit/krahinës time</b><br>Nxiten nxënësit të tregojnë historinë/ tregimin e një dëshmori që ata dinë nga qyteti i tyre, duke treguar disa karakteristika të trimërisë së këtij dëshmori.                   |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;</li><li>- shpreh emocionet e veta rreth muzikës dhe tekstit të këngës;</li><li>- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.</li></ul>  |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- melodia e këngës;</li><li>- teksti i këngës;</li><li>- rregullat e këndimit.</li></ul> |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me këngën;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Shkencat shoqërore.</li></ul>   |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |  |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të tregojnë historinë/ tregimin e një dëshmori që ata dinë nga qyteti i tyre, duke treguar disa karakteristika të trimërisë së këtij dëshmori.   |               |  |           |
| <h2 style="text-align: center;">HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</h2> <p><b>Ndërtimi i njohurive të reja</b></p>  <b>Dëgjohet</b> kënga “O i vogël o partizan” dhe <b>vazhdohet</b> puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"><li>• këndohet kënga varg pas vargu;</li><li>• përsëriten vargjet herë pas here;</li><li>• këndohet strofa;</li><li>• këndohet strofa dhe refreni;</li><li>• përsëritet kënga nga fillimi në fund;</li><li>• interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;</li><li>• këndohet kënga vetëm dhe në grup.</li></ul> <div style="text-align: right;"></div> <p style="text-align: center;"><i>“Prita partizane”, pikturë nga<br/>Nexhmedin Zajmi</i></p> |               |  |           |

### Teksti i këngës: “O i vogël o partizan”

#### - I -

Ke marrë pushkën  
ke dalë për liri vatan,  
Ke marrë pushkën  
ke dalë për liri vatan.

#### - Refreni -

Se fshatari nga vatra ty s'të ndan,  
O i vogël o partizan.

#### - II -

Dhe në qoftë se vritesh,  
nëna ty s'të qan,  
dhe në qoftë se vritesh,  
nëna ty s'të qan,

#### - Refreni -

Se ti re për liri e për vatan,  
o i vogël o partizan.

Largo

Partizane

*p* Ke marr push - kën ke - dal për li - ri va - tan -

*mf* Dhe fsha - ta - ri nga va - tra ty s'të ndan

*p* O i vo - gël o par - ti - zan zan-





■ **Gjatë mësimimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.




#### ► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (këngët partizane).
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|--|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi muzikor<br><br><b>Tema mësimore:</b> Krijojmë modele me ritmin me 2 dhe 3 goditje  |               | <b>Situata: Krijim im ritmik</b><br>U kërkohet nxënësve të krijojnë modele ritmike me dy dhe tri goditje nëpërmjet simboleve, goditjeve me shuplaka apo me instrumenteve me goditje. Shpjegojnë duke ritmizuar modelin e krijuar.                             |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- improvizon në ritme me dy dhe tri goditje;</li><li>- improvizon modele ritmike me dy goditje dhe tri goditje me gjatësi të ndryshme;</li><li>- krijon modele me dy apo tri goditje në fletoren e vet.</li></ul>  |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- ritëm me dy goditje;</li><li>- ritëm me tri goditje;</li><li>- gjatësi ritmike me dy dhe tri goditje.</li></ul> |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me shembuj;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Matematika;</li><li>- Gjuha.</li></ul>   |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon duke i nxitur nxënësit të krijojnë në mënyrë vizuale apo nëpërmjet simboleve gjatësinë <i>gjatë, të shkurtër, shumë të shkurtër dhe shumë të gjatë</i> . Gjithashtu, ata nxiten të krijojnë modele të ndryshme gjatësish nëpërmjet fjalëve apo simboleve të ndryshme.  |               |   |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b>  |               |   |           |
| <b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të vëzhgojnë figurat në fletoren e tyre dhe të shkruajnë kush janë objektet që lëshojnë tinguj me dy goditje.  |               |   |           |
| <b>Hapi II</b> U kërkohet nxënësve të ushtrohen me kujdes duke vëzhguar tabelën që iu paraqet mësuesi, të shkruajnë kush janë objektet që lëshojnë tinguj me më shumë se dy goditje pra me tre.  |               |   |           |
| <b>Hapi III</b> Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të krijojnë sipas imagjinatës së tyre simbole që të japin idenë e një - dy goditjeve dhe të pushimit, <i>për shembull pika e shiut kur bie në tokë</i> .  |               |   |           |
| <b>Hapi IV</b> Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke u vendosur sipër çdo rrokjeje simbolin tënd të krijuar prej teje, i cili nënkupton 1 dhe 2 goditje apo pushimin.  |               |   |           |
| <b>► Vlerësimi</b><br>Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të <i>rezultateve të arritura</i> në: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: <i>krijimi i modeleve ritmike me dy goditje</i>;</li><li>- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të ritmit me dy goditje nëpërmjet simboleve të ndryshme sipas dëshirës;</li><li>- demonstrimin e shembujve ritmike me shuplaka dhe të regjistrimit grafik të krijuar vetëm ose në grup duke e shpjeguar atë.</li></ul> |               |   |           |
| <b>Detyra:</b> Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.   |               |   |           |

| Fusha: Arte   | Lënda: Muzikë | Shkalla: II  | Klasa: IV |
|---|---------------|--|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Kënga: “Bleta dhe flutura”  |               | <b>Situata: Insektet</b><br>Shpërndahen foto të ndryshme ku nxënësit veçojnë insektet, duke shpjeguar çdo njohuri që kanë për to, rëndësinë apo të mirat materiale të tyre.  |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>- këndon këngën me ndjenjë dhe emocione;</li> <li>- shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës;</li> <li>- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.</li> </ul> |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- melodia e këngës;</li> <li>- teksti i këngës;</li> <li>- e këndimit.</li> </ul> |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cd me këngën;</li> <li>- materiale të parapërgatitura;</li> <li>- fletorja e nxënësit;</li> <li>- teksti i mësuesit.</li> </ul>  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- gjuha dhe komunikimi;</li> <li>- njohuri për shoqërinë.</li> </ul>   |           |



### Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

#### *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve*

Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit, të cilët/at nxiten që të shprehen rreth fotove të ndryshme që shikojnë ku nxënësit veçojnë insektet, duke shpjeguar çdo njohuri që kanë për to, rëndësinë apo të mirat materiale të tyre. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali. Nxënësit/et nxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe shoqërohet me zilka. U kërkohet që ata të skicojnë përmes vizatimit bletën ose fluturën.

### HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:

#### *Ndërtimi i njohurive të reja*



**Dëgjohet** kënga: “Bleta dhe flutura” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocione;
- kënga vetëm dhe në grup.



### Teksti i këngës: "Bleta dhe flutura"

#### - I -

Bleta dhe një flutur,  
bashkë fluturuan,  
mbi lule të bukura,  
Të dyja qëndruan.

#### - II -

Bleta përmby lule,  
Shkoj për të punuar,  
flutura mes luleve, për t'u zbukuruar.

#### - Refreni -

Edhe ne si bleta,  
të bukur si jeta,  
do të marrim dhjeta,  
në mësim përher'.  
Se jemi pun'torë,  
nxënës shëmbullorë,  
puna të ndrin ballin,  
të jep g'zim dhe nder.

Moderato

Teksti: E. Cenolli

Muzika: Z. Zani

Ble - ta dhe një flu - tur bash - kë flu - tu - ru - an  
Ble - ta për - mbi lu - le shkoj për të pu - nu - ar  
mbi lu - le të bu - ku - ra të dy - ja qën - dru - an.  
flu - tu - ra mes lu - le - ve për tu zbu - ku - ru - ar  
E - dhe ne si ble - ta të bu - kur si  
Se je - mi pun - to - rë nxë - nës shem - bu -  
je - ta do të ma - rrim dhje - ta  
llo - rë pu - na të ndrin ba - llin  
1. në më - sim për - her' 2. të jep g'zim e nder.




■ **Gjatë mësimimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit*, të *intonacionit* dhe të *interpretimit* të këngës.

#### ► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (bletën dhe të mirat e saj materiale);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).







- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|--|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika & procese<br><b>Tema mësimore:</b> <i>Ritmi, dinamika, karakteri, ngjyrimi</i>  |               | <b>Situata: Fjalori muzikor</b><br>Dëgjohen disa fragmente muzikore dhe çdo nxënës duhet të përmbledhë me një fjalë të vetme atë çka dëgjon nga muzika. Rrethohen fjalët <i>ritëm, dinamikë, shpejtësi dhe karakter</i> ; fjalë të cilat do të shpjegohen për të ditur më mirë kuptimin e tyre. |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon nëpërmjet dëgjimit <i>ritmin, dinamikën, karakterin dhe ngjyrimin në muzikë</i>;</li><li>- shpjegon kuptimin e tyre;</li><li>- analizon ndryshueshmërinë e veprës muzikore me përdorimin e termave që mësuuan;</li><li>- krijon një fjalor të thjeshtë muzikor.</li></ul>  |               | <input checked="" type="checkbox"/> <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- ritëm;</li><li>- dinamika;</li><li>- karakteri.</li></ul>   |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me shembuj muzikore;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- libri i mësuesit.</li></ul>   |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Gjuha dhe komunikimi</li></ul>   |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon duke vendosur disa fragmente muzikore për dëgjim, ku çdo nxënës duhet të përmbledhë me një fjalë të vetme atë çka dëgjon nga muzika. Rrethohen fjalët <i>ritëm, dinamikë, ngjyrim dhe karakter</i> ; fjalë të cilat do të shpjegohen për të ditur më mirë kuptimin e tyre.   |               |   |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br><b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve të dëgjojnë me vëmendje fragmentet muzikore dhe të shënojnë një fjalë në dërrasë apo fletoren e tyre. Qëllimi është që të dalin fjalët <i>ritëm, dinamikë, ngjyrim dhe karakter</i> ; fjalë të cilat do të shpjegohen për të ditur më mirë kuptimin e tyre.<br><b>Hapi II</b> Vendoset për dëgjim edhe një herë fragmentet muzikore dhe u kërkohet nxënësve të identifikojnë përmes dëgjimit pikërisht termat të cilat u veçuan më sipër. Nxënësit/et diskutojnë rreth tyre duke dhënë fillimisht ata kuptimin për to.<br><b>Hapi III</b> Vazhdohet më tej puna duke dhënë një shpjegim të qartë rreth tyre dhe konkretizuar me këngë të mësuara apo me fragmente të ndryshme muzikore.<br><b>Hapi IV</b> Nxënësit përshkruajnë një këngë apo melodi që ata pëlqejnë, duke përdorur termat e mësuara. |               |   |           |







| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|--|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Kënga: “Njëshi dhe zeroja”   |               | <b>Situata: Muzika dhe numrat</b><br>Nxënësit nxiten të flasin për numrat dhe lidhjen e matematikës me muzikën. Ata shprehen në mënyra të ndryshme duke rikujtuar edhe një nga karakteristikat e gjatësisë së ritmit me të cilën krijojmë muzikë. |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;</li><li>- shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës;</li><li>- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.</li></ul>   |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- melodia e këngës;</li><li>- teksti i këngës;</li><li>- rregullat e këndimit.</li></ul>              |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me këngën;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- gjuha dhe komunikimi;</li><li>- njohuri për shoqërinë.</li></ul>   |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të shprehen rreth numrave. Nxënësit nxiten të flasin për numrat dhe lidhjen e matematikës me muzikën. Ata shprehen në mënyra të ndryshme duke rikujtuar edhe një nga karakteristikat e gjatësisë së ritmit me të cilën krijojmë muzikë. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali.<br>Nxënësit/et nxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe shoqërohet me shuplaka apo instrument me goditje.                                     |               |   |           |
| <b>HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</b><br><b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br> <b>Dëgjohet kënga: “Njëshi dhe zeroja” dhe vazhdohe puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• këndohet kënga varg pas vargu;</li><li>• përsëriten vargjet herë pas here;</li><li>• këndohet strofa;</li><li>• këndohet strofa dhe refreni;</li><li>• përsëritet kënga nga fillimi në fund;</li><li>• interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;</li><li>• këndohet kënga vetëm dhe në grup.</li></ul>  |               |   |           |

### Teksti i këngës: “Njëshi dhe zeroja”

#### - I -

Un' jam njëshi numr' i par',  
fjalën time pa dëgjoni,  
se nga un' nis pun' e mbar'  
këtë kurr' mos e harroni.  
Se pa mua s'ka milion,  
nuk ka mij'she nuk ka dhjet',  
numërimi nuk fillon,  
në gjith' numrat un' jam mbret.  
Pra dëgjoni fjalën time,  
gjith' ku jeni e ku s'jeni,  
dhe mos bëni diskutime  
se pa mua zero jeni.

#### - II -

Zeroja, kur e dëgjoi,  
i tha njëshit qet e qet',  
nëse un' s'të shoqëroj,  
ti nuk bëhesh dot as dhjet'.  
S'bëhesh qind'she, as milion,  
s' bëhesh dot as dysh as tet',  
vetëm ti, a e kupton,  
veç për vete ti je mbret.  
Numr' i par' je pa dyshim,  
po ta dish, o mor i mjer',  
se pa numrat në vazhdim,  
vetëm njëshin ke si vler'.

Teksti: Jorgo Papingji  
Muzika: Agim Rreza

Allegro

Un' jam një - shi numr' i par' fja - lën ti - me pa dë - gjo - ni  
Se pa mu - a s'ka mil - jon nuk ka mij - she nuk ka dhjet'

se nga un' nis pun' e mbar' kë - të kurr' mos e ha - rro - ni  
Nu - më - ri - mi nuk fi - llon

në gjith' nu - mrat un' jam mbret. Pra dë - gjo - ni fja - lën ti - me

gjith ku je - ni e ku s'je - ni dhe mos bë - ni dis - ku - ti - me

se pa mu - a ze - ro je - ni se pa mu - a ze - ro je - ni.

■ **Gjatë mësimimit të këngës,** tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.*

#### ► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/a jo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (numrat).
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

## PLANIFIKIMI TREMUJOR 1, PERIUDHA: PRILL – QERSHOR

### REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

#### Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

1. Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike.
2. Kupton mesazhet nëpërmjet simboleve muzikore që u drejtohen.
3. Shpjegon në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve dhe formave artistike.
4. Komunikon në mënyrë të pavarur dhe krijuese mundësitë e të shprehurit në muzikë.

#### Kompetenca e të menduarit

1. Mendon në mënyrë krijuese në situata të ndryshme të të menduarit.
2. Përpunon njohuritë në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.
3. Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.
4. Demonstron realizimin e një krijimi/interpretimi në një veprimtari muzikore.

#### Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

1. Përdor mjetet për të realizuar një krijim muzikor.
2. Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim muzikor.
3. Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën muzikore.

#### Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

1. Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.

#### Kompetenca personale

1. Zhvillon besimin te vetja gjatë krijimit/performimit/vlerësimit muzikor respekton punën e vet dhe të tjerëve.
2. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

#### Kompetenca qytetare

1. Diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.

#### Kompetenca digjitale





1. Përdor mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.






| Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës   |  |   |
|---|--|---|
| <i>Krijimi muzikor</i>  | <i>Interpretimi muzikor</i>  | <i>Vlerësimi muzikor</i>  |
| <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>krijon me modele ritmike me dy, tri dhe katër goditje;</li> <li>krijon modele ritmike me mjete trupore, me zë dhe simbole, duke vënë në pah theksin e fortë gjatë ritmizimit të tyre;</li> <li>krijon simbole grafike për këto ritme;</li> <li>karakterin e pjesëve muzikore kur luhen ose këndohen; improvizon mbi një këngë apo melodi sipas ritmit apo karakterit të melodisë.</li> </ul> | <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>interpretin këngë dhe lojëra muzikore në kohët 2, 3, 4 kohë; interpretin këngë apo lojëra muzikore, duke demonstruar kuptimin shpejtësisë së muzikës sipas terminologjisë së mësuar; luan ksilofon sipas alfabetit muzikor;</li> <li>këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;</li> <li>interpretin këngë për fëmijë duke iu përshtatur teksteve të këngës; interpretin këngët me ndjenjë dhe emocione;</li> <li>luan me instrumentet ORF apo me mjete trupore sipas simbolikës së përdorur në ritme me dy, tri dhe katër goditje;</li> <li>performon/interpretin këngët në festat e klasës apo të shkollës;</li> <li>komunikon mendimin e vet rreth këngës së interpretuar; interpretin dhe reflekton emocionet që i krijon një këngë, apo pjesë muzikore gjatë interpretimit;</li> <li>vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve.</li> </ul> | <p><b>Nxënësi/ja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>shpjegon ndryshimin ritmik tek këngët me dy, tri dhe katër goditje;</li> <li>bën lidhje të shembujve të ndryshueshmërisë së shpejtësisë së muzikës nëpërmjet shembujve muzikore që dëgjon, duke shpjeguar emocionet që i krijohen;</li> <li>shpreh emocionet e veta për këngët që këndon;</li> <li>përdor elementet e gjuhës muzikore gjatë shpjegimit emocional;</li> <li>bën lidhje ndërmjet asaj që ndien dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore;</li> <li>shpreh qartë mendimin e vet emocional për këngët apo veprat muzikore, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore gjatë argumentimit të ndjenjës emocionale që i shkakton muzika;</li> <li>përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; respekton mendimin e shokëve;</li> <li>respekton pjesë muzikore të kulturave të tjera; merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës;</li> <li>përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.</li> </ul> |

| Nr. | Tematika <sup>4</sup> | Temat mësimore                        | Situata e të nxënit  | Burime dhe materiale  |
|-----|-----------------------|---------------------------------------|--|---|
| 1   | <i>GJ&amp;KM</i>      | Ritmi me katër goditje theksi muzikor | <b>Situata:</b> U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalë me katër rrokje. Më pas ata rrethojnë rrokjen ku bie theksi i fortë dhe gjysmë i fortë dhe e shqiptojnë atë.   | - Cd me shembuj;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit. |
| 2   | <i>T&amp;P</i>        | Kënga: “Nëna Shqipëri”                | <b>Situata: Kuic për atdheun</b><br>Nxënësit të ndahen në grupe dhe u kërkohet të bashkëpunojnë me njëri tjetrin që brenda 5 minutave të sjellin një krijim me temë “Atdheu im”.   | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.  |
| 3   | <i>GJ&amp;KM</i>      | Krijojmë ritmin me 4 goditje          | <b>Situata: Krijim im me ritmin</b><br>U kërkohet nxënësve të krijojnë modele ritmike me 4 goditje nëpërmjet simboleve, goditjeve me shuplaka apo me instrumentet me goditje. Shpjegojnë duke ritmizuar modelin e krijuar.           | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.  |
| 4   | <i>T&amp;P</i>        | “Erdhi një dallëndyshe”               | <b>Situata: Shpendët</b><br>Me një kuic të shkurtër nxiten nxënësit të flasin rreth shpendëve që ata njohin më mirë. Pastaj drejtohet diskutimi rreth dallëndyshe, kohës kur ato vijnë dhe ngrenë folenë dhe kohës kur ato largohen. | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.  |

|  |                  |                                |   |  |
|--|------------------|--------------------------------|---|--|
| 5  | <i>T&amp;P</i>   | Kënga: “Sa herë vjen qershori” | <b>Situata: Ora e fundit</b><br>Nxiten nxënësit të shprehen rreth muzikës dhe njohurive që ata kanë marrë në shkollë gjatë vitit. Por ata nxiten të flasin edhe për pushimet që i presin. | - Cd;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- Fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit.           |
| 6  | <i>HM&amp;SH</i> | Vallëzojmë sipas ritmit        | <b>Situata: Vallëzimi im i preferuar</b><br><br>Vendoset disa melodi në sfond dhe nxiten nxënësit të performojnë kërcime sipas melodisë që ata dëgjojnë.                                  | - Cd me këngën;<br>- materiale të parapërgatitura;<br>- Fletorja e nxënësit;<br>- teksti i mësuesit. |
| 7  | <i>T&amp;P</i>   | Koncert                        |   | - <b>Cd</b>  |
| <p align="center"><b>Metodologjia e mësimdhënies për çdo orë mësimore</b></p> <p>Çdo orë mësimore ndërtohet duke u bazuar në strukturën ERR dhe teknikat e mësimdhënies. Gjithashtu, muzika si lëndë praktike mbështet dhe zhvillon shumë teknikat bashkëvepruese, interaktive, gjithëpërfshirëse si: improvizimi, bashkëbisedimi, punë vetëm dhe në grup, ose këndimi solo dhe në grup.</p> |                  |                                |   |  |
| <p align="center"><b>Vlerësimi</b></p> <p>Demonstrim i rezultateve të arritura në temën e re lidhur me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.</p> <p>Demonstrim i rezultateve të arritura të interpretimit të këngës dhe diskutimit ndaj melodisë dhe tekstit.</p> <p>Demonstrim i rezultateve të arritura nëpërmjet detyrave të kryera dhe vendosura në portofol.</p>                       |                  |                                |   |  |

<sup>4</sup> **GJ&KM** - Gjuha dhe komunikimi muzikor; **T&P** - Teknika dhe procese; **HM&SH** - Historia, muzika dhe shoqëria

| Fusha: Arte   | Lënda: Muzikë | Shkalla: II  | Klasa: IV |
|---|---------------|--|-----------|
| <b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi muzikor<br><br><b>Tema mësimore:</b> Ritmi me 4 goditje   |               | <b>Situata: Unë dhe ritmi</b><br>U kërkohet nxënësve të gjejnë fjalë me katër rrokje. Më pas, ata rrethojnë rrokjen ku bie theksi i fortë dhe gjysmë i fortë dhe e shqiptojnë atë.   |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- gjen fjalë me 4 rrokje duke përcaktuar rrokjen ku bie theksi i fortë dhe gjysmë i fortë;</li><li>- improvizon dhe krijon ritme me 4 goditje;</li><li>- improvizon modele ritmike me 4 goditje me gjatësi të ndryshme;</li><li>- krijon modele me gjatësi ritmike të ndryshme që formojnë ritmin me 4 goditje në fletoren e vet.</li></ul>   |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- ritëm me 4 goditje;</li><li>- modele me gjatësi ritmike të ndryshme që formojnë ritmin me 4 goditje.</li></ul> |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me shembuj;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Matematika;</li><li>- Gjuha;</li><li>- Arti pamor.</li></ul>  |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |  |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me veprimtari konkrete ku iu kërkohet nxënësve të gjejnë fjalë me katër rrokje. Më pas ata rrethojnë rrokjen ku bie theksi i fortë dhe gjysmë i fortë dhe e shqiptojnë atë. Më tej vazhdohet ku nxënësit nxiten të pasqyrojnë në mënyrë vizuale apo nëpërmjet simboleve gjatësinë shumë të shkurtër dhe shumë të gjatë.   |               |  |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br><b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të gjejnë fjalë me 4 rrokje dhe pasi t'i kenë gjetur të ngjyrosin rrokjen e cila theksohet më fort dhe gjysmë fort.<br><b>Hapi II</b> U shpjegohet se ashtu si te fjala edhe në muzikë ka thekse të fortë, gjysmë të fortë dhe thekse të butë.<br><b>Hapi III</b> Vazhdohet më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të krijojnë sipas imagjinatës së tyre simbole që të japin idenë e ritmit me 4 goditje. Gjithashtu ata nxiten të krijojnë modele të ndryshme gjatësish nëpërmjet fjalëve apo simboleve të ndryshme grafike.<br><b>Hapi IV</b> U kërkohet nxënësve pasi të kenë krijuar modele ritmike me 4 goditje ta lexojnë atë. |               |  |           |
| <b>Vlerësimi</b><br>Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të rezultateve të arritura në: <ul style="list-style-type: none"><li>- shpjegimin mbi ritmin me 4 goditje dhe theksin muzikor;</li><li>- krijimin e modeleve me 4 goditje nëpërmjet simboleve të ndryshme;</li><li>- shqërtimin e modeleve ritmike të krijuara me shuplaka vetëm ose në grup.</li></ul><br><b>Detyra:</b> Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.   |               |  |           |

| Fusha: Arte   |  | Lënda: Muzikë |  | Shkalla: II  |  | Klasa: IV |  |
|---|--|---------------|--|--|--|-----------|--|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Kënga: “Nëna Shqipëri”  |  |               |  | <b>Situata: Kuic për atdheun</b><br>Nxënësit të ndahen në grupe dhe u kërkohet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin që brenda 5 minutave të sjellin një krijim me temë “Atdheu im”. |  |           |  |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;</li><li>- shpreh emocionet e veta rreth muzikës dhe tekstit të këngës;</li><li>- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.</li></ul>   |  |               |  | <input checked="" type="checkbox"/> <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- teksti i këngës;</li><li>- rregullat e këndimit.</li></ul>                       |  |           |  |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me këngën;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |  |               |  | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Shkencat shoqërore;</li><li>- Gjuha dhe komunikimi;</li><li>- Arti pamor.</li></ul>                     |  |           |  |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>   |  |               |  |  |  |           |  |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të flasin rreth vendlindjes së tyre. Ndahen në grupe dhe u kërkohen që brenda 5 minutave të sjellin një kujtim me temë “Atdheu im”.   |  |               |  |  |  |           |  |
| <b>HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</b><br><b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br> <b>Dëgjohet</b> kënga “Nëna Shqipëri” dhe <b>vazhdohet</b> puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"><li>• këndohet kënga varg pas vargu;</li><li>• përsëriten vargjet herë pas here;</li><li>• këndohet strofa;</li><li>• këndohet strofa dhe refreni;</li><li>• përsëritet kënga nga fillimi në fund;</li><li>• interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;</li><li>• kënga vetëm dhe në grup.</li></ul> |  |               |  |    |  |           |  |



### Teksti i këngës: “Nëna Shqipëri”

#### - I -

Vend' i im i dashur,  
nëna Shqipëri,  
për ty na rreh zemra,  
plot me dashuri.

#### - Refreni -

Nëna Shqipëri,  
nëna jon' e madhe,  
mbi të gjithë dua,  
njer'zit edhe malet.

#### - II -

T'i dua me shpirt,  
me zjarr të pashuar,  
fushat e begata,  
malet borë mbuluar.

#### - Refreni -

Nëna Shqipëri,  
nëna jon' e madhe,  
mbi të gjithë dua,  
njer'zit edhe malet.

Allegro

Teksti: M. Gazioni  
Muzika: L. Deda

Vend' i im i da - shur Në - na Shqi - pë - ri

ri Për ty na rreh ze - mra Plot me da - shu - ri.

ri. ri. Në - na Shqi - pë - ri

Në - na jon' e ma - dhe Mbi të gji - thë du - a

njer' - zit e - dhe ma - let. njer' - zit e - dhe ma - let. D.C.




■ **Gjatë mësimimit të këngës,** tregohet kujdes për respektimin e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës.






#### ► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultatetve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (atdheun);
- me emocion të këngës;
- dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II  | Klasa: IV |
|--|---------------|--|-----------|
| <b>Tematika:</b> Gjuha dhe komunikimi muzikor  |               | <b>Situata: Krijim im me ritmin</b><br>U kërkohet nxënësve të krijojnë ushtrim që të formojnë ritmin me 4 goditje nëpërmjet simboleve të ndryshme. Ata e lexojnë dhe shpjegojnë ushtrimin e krijuar. |           |
| <b>Tema mësimore:</b> Krijojmë modele me ritmin me 4 goditje   |               | <b>✓ Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- ritëm me 4 goditje;</li><li>- modele me gjatësi ritmike të ndryshme që formojnë ritmin me 4 goditje.</li></ul>                         |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- improvizon në ritme me 4 goditje;</li><li>- improvizon modele ritmike me 4 goditje me gjatësi të ndryshme;</li><li>- krijon modele me 4 goditje në fletoren e vet.</li></ul>   |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Matematika;</li><li>- Gjuha.</li></ul>  |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me shembuj;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |               |  |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |  |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Njohuritë mbi ritmin me 4 goditje vazhdohe duke u kërkuar nxënësve që nëpërmjet një simboli që ata dëshirojnë të krijojnë modele të ndryshme gjatësish të ndryshme.  |               |  |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b>  |               |  |           |
| <b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve të krijojnë një simbol i cili do të nënkuptojë gjatësi të ndryshme ritmike për ritmin me 4 goditje.  |               |  |           |
| <b>Hapi II</b> U kërkohet nxënësve të krijojnë një ushtrim në fletoren e tyre, duke përdorur simbolin që ata krijuan vetë.   |               |  |           |
| <b>Hapi III</b> Vazhdohe më tej puna me nxënësit, duke i vendosur të krijojnë sipas imagjinatës së tyre ushtrimin me gjatësi ritmike të ndryshme që formojnë ritmin me 4 goditje.  |               |  |           |
| <b>Hapi IV</b> U kërkohet nxënësve të lexojnë krijimin e tyre.   |               |  |           |
| <b>► Vlerësimi</b><br>Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të <i>rezultateve të arritura</i> në: <ul style="list-style-type: none"><li>- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: <i>krijimi i modeleve ritmike me 4 goditje</i>;</li><li>- bashkëpunimin për krijimin dhe regjistrimin grafik të ritmit me 4 goditje nëpërmjet simboleve të ndryshme sipas dëshirës;</li><li>- demonstrimin përmes leximit të krijimit, duke e shpjeguar atë.</li></ul> |               |  |           |
| <b>Detyra:</b> Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.   |               |  |           |

| Fusha: Arte  |  | Lënda: Muzikë |  | Shkalla: II  |  | Klasa: IV |  |
|--|--|---------------|--|--|--|-----------|--|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese   |  |               |  | <b>Situata: Shpendët</b>   |  |           |  |
| <b>Tema mësimore:</b> Kënga: “Erdhi një dallëndyshe”   |  |               |  | Me një kuic të shkurtër nxiten nxënësit të flasin rreth shpendëve që ata njohin më mirë. Pastaj drejtohet diskutimi rreth dallëndyshe, kohës kur ato vijnë dhe ngrenë folenë dhe kohës kur ato largohen. |  |           |  |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b>   |  |               |  | <input checked="" type="checkbox"/> <b>Fjalët kyçe:</b>  |  |           |  |
| Nxënësi/ja:  |  |               |  | - melodia e këngës;  |  |           |  |
| - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;  |  |               |  | - teksti i këngës;   |  |           |  |
| - shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës;  |  |               |  | - rregullat e këndimit.  |  |           |  |
| - përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.   |  |               |  |  |  |           |  |
|  <b>Burimet:</b>  |  |               |  | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b>   |  |           |  |
| - me këngën;   |  |               |  | - gjuha dhe komunikimi;  |  |           |  |
| - materiale të parapërgatitura;  |  |               |  | - njohuri për shoqërinë.   |  |           |  |
| - fletorja e nxënësit;   |  |               |  | - dituri natyre.   |  |           |  |
| - teksti i mësuesit.   |  |               |  |  |  |           |  |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |  |               |  |  |  |           |  |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b>   |  |               |  |  |  |           |  |
| Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit, të cilët/at nxiten që të shprehen rreth fotove të ndryshme që shikojnë ku nxënësit veçojnë shpendët, duke shpjeguar çdo njohuri që kanë për to, rëndësinë apo të mirat materiale të tyre. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali. Nxënësit/et nxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe shoqërohet me zilka. U kërkohet që ata të skicojnë përmes vizatimit dallëndyshen. |  |               |  |  |  |           |  |
| <b>HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</b>   |  |               |  |  |  |           |  |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b>  |  |               |  |  |  |           |  |
|  <b>Dëgjohet</b> kënga: “Erdhi një dallëndyshe” dhe <b>vazhdohet</b> puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:  |  |               |  |  |  |           |  |
| <ul style="list-style-type: none"><li>• këndohet kënga varg pas vargu;</li><li>• përsëriten vargjet herë pas here;</li><li>• këndohet strofa;</li><li>• këndohet strofa dhe refreni;</li><li>• përsëritet kënga nga fillimi në fund;</li><li>• interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;</li><li>• kënga vetëm dhe në grup.</li></ul>  |  |               |  |  |  |           |  |
|    |  |               |  |  |  |           |  |



### Teksti i këngës: “Erdhi një dallëndyshe”

#### - I -

Në ballkonin e shtëpisë,  
pa shiko moj gjyshe,  
pranë degës së qershisë  
erdh' një dallëndyshe.

#### - Refreni -

Eja dallëndyshe,  
bashk' me shoqet o,  
në shtëpinë tonë  
ti fole ndërto.

#### - II -

E pa gjyshja dallëndyshen  
dhe doli te dera,  
dëgjo bijë, më tha mua,  
na erdhi pranvera.

#### - Refreni -

Eja dallëndyshe,  
bashk' me shoqet o,  
në shtëpinë tonë  
ti fole ndërto.

**Allegro**

**Muzika: Limoz Dizdari**

Në ball - ko - nin e shtë - pi - së pa shi - ko moj  
gjy - she Pra - në de - gës së qer - shi - së  
erdh' një da - llën - dy - she  
E - ja da - llën - dy - she bashk' me  
sho - qet o Në shtë - pi - në  
to - në ti fo - le ndër - to






■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit të këngës*.

#### ► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (shpendët - dallëndyshja);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

| Fusha: Arte  | Lënda: Muzikë | Shkalla: II   | Klasa: IV |
|--|---------------|---|-----------|
| <b>Tematika:</b> Teknika dhe procese<br><br><b>Tema mësimore:</b> Kënga: “Sa her’ vjen qershori”   |               | <b>Situata: Ora e fundit</b><br>Nxiten nxënësit të shprehen rreth muzikës dhe njohurive që ata kanë marrë në shkollë gjatë vitit. Por ata nxiten të flasin edhe për pushimet që i presin. |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- këndon këngën me ndjenjë dhe emocion;</li><li>- shpreh emocionet e veta për tekstin dhe muzikën e këngës;</li><li>- përjeton dhe shpjegon muzikën, duke përdorur një fjalor të thjeshtë.</li></ul>   |               | <input checked="" type="checkbox"/> <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- melodia e këngës;</li><li>- teksti i këngës;</li><li>- rregullat e këndimit.</li></ul>    |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me këngën;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>  |               | <b>Lidhja me fushat e tjera:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- gjuha dhe komunikimi;</li><li>- njohuri për shoqërinë.</li></ul>   |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |   |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit, të cilët/at nxiten që të shprehen rreth pushimeve dhe festës së 1 Qershorit, duke shpjeguar çdo njohuri që kanë për to. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali. Nxënësit/et nxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe shoqërohet me zilka. U kërkohet që ata të skicojnë përmes vizatimit vendin ku ata dëshirojnë të kalojnë pushimet. |               |   |           |
| <b>HAPAT QË DUHEN NDJEKUR:</b>   |               |   |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br> <b>Dëgjohet</b> kënga: “Sa her’ vjen qershori” dhe <b>vazhdohet</b> puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"><li>• këndohet kënga varg pas vargu;</li><li>• përsëriten vargjet herë pas here;</li><li>• këndohet strofa;</li><li>• këndohet strofa dhe refreni;</li><li>• përsëritet kënga nga fillimi në fund;</li><li>• interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;</li><li>• kënga vetëm dhe në grup.</li></ul>     |               |   |           |
|    |               |   |           |

### Teksti i këngës: "Sa her' vjen qershori"

#### - I -

Sa her' vjen qershori,  
më zilja s'ting' llon, n  
jë vit e më e rritur,  
gjithnjë bëhet klasa jon'.

Sa librat i lëmë,  
te loja përsëri,  
se jemi të gjithë  
sërish fëmij'.

#### - Refreni -

Ne nisim me futboll,  
vajzat volejball,  
topin në rrjet e çoj,  
pikët un' shënoj.  
Klasa kur barazon,  
humbje jo kurr' nuk njih,  
doras ndeshjen fi tojm'.

#### - II -

Sa her' vjen qershori,  
shpesh këngët më çojn',  
në fushën ton' të blertë,  
me një top në mes gjithmon.  
Mbaron një pjes' loje,  
nis tjetra përsëri,  
është bota ime  
se jam fëmij'.

Teksti: Alfred Çapaliku  
Muzika: Nexhat Rexha

**Allegretto**

Sa her' vjen qer- sho - ri më zil - ja s'ting' - llon Një  
Sa her' vjen qer- sho - ri shpesh këm - bët më çojn' në

1. vit dhe më e rri - tur gjith - një bë - het kla - sa jon' Sa  
fu - shën ton' të bler - të me një top në mes gjith - mon' Mba -

2. li - brat i lë - më tek lo - ja për - së - ri se  
ron një pjes' lo - je nis tje - tra për - së - ri është'

je - mi të gji - thë së - rish fë - mij'  
bo - ta e i - me se jam fë - mij'.

E ni - sim me fut - boll, vaj - zat vo - lej - boll to - pin në rrjet' e çoj

pi - kët un' shë - noj kla - sa kurr' s'ba - ra - zon hum - bje jo kurr' nuk njih





1. çdo rast nde - shjen fi - tojm'. 2. çdo rast nde - shjen fi - tojm'.

■ **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit*, të *intonacionit* dhe të *interpretimit* të këngës.

#### ► **Vlerësimi**

Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të *rezultateve të arritura* në:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (qershori muaji i fundit i shkollës);
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).
- **Detyra:** Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit ruhen në dosjen e tyre personale.

| Fusha: Arte   | Lënda: Muzikë | Shkalla: II  | Klasa: IV |
|---|---------------|--|-----------|
| <b>Tematika:</b> Historia, muzika dhe shoqëria<br><b>Tema mësimore:</b> <i>Vallëzojmë sipas ritmeve</i>   |               | <b>Situata: Vallëzimi im i preferuar</b><br>Vendoset disa lloje melodish ritmike dhe të qetë në sfond dhe nxiten nxënësit të performojnë kërcime sipas melodisë që ata dëgjojnë. |           |
|  <b>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore</b><br>Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"><li>- identifikon sipas ritmeve melodi të ndryshme;</li><li>- krijon një koreografi të caktuar për të demonstruar njohuritë që ka mbi kërcimin;</li><li>- shpjegon krijimin muzikor me një fjalor të thjeshtë muzikor.</li></ul>  |               |  <b>Fjalët kyçe:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- kërcim</li></ul>                   |           |
|  <b>Burimet:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Cd me shembuj muzikore;</li><li>- materiale të parapërgatitura;</li><li>- fletorja e nxënësit;</li><li>- teksti i mësuesit.</li></ul>   |               |  |           |
|  <b>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</b>  |               |  |           |
| <b>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</b><br>Mësimi fillon duke vendosur disa lloje melodish ritmike dhe të qetë në sfond dhe nxiten nxënësit të performojnë kërcime sipas melodisë që ata dëgjojnë.   |               |  |           |
| <b>Ndërtimi i njohurive të reja</b><br><div><b>Hapi I</b> Mësuesi/ja fillon mësimin duke ndarë nxënësit në grupe dhe nxitur ata të listojnë disa melodi që ata duan të kërcëjnë në klasë.</div> <div><b>Hapi II</b> U kërkohet nxënësve të krijojnë një koreografi me lëvizje trupore duke respektuar edhe melodinë.</div> <div><b>Hapi III</b> Vazhdohet më tej ku juria vlerëson secilin grup për performancën që demonstrojnë.</div> <div><b>Hapi IV</b> Nxënësit kërcëjnë të gjithë së bashku melodinë e grupit fitues.</div> |               |  |           |
| <b>Vlerësimi</b><br>Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet në bazë të <i>rezultateve të arritura</i> në: <ul style="list-style-type: none"><li>- përcaktimin e melodisë për zhvillimin e krijimit të vet;</li><li>- krijimin e një koreografie të caktuar për të demonstruar njohuritë që ka mbi kërcimin;</li><li>- shpjegimin e krijimit muzikor me një fjalor të thjeshtë muzikor.</li></ul> <ul style="list-style-type: none"><li>- <b>Detyra:</b> Punimi nga nxënësit ruhet në dosjen e tyre personale.</li></ul>               |               |  |           |



# “Billy Boy”

Oh, were have you been,  
Billy Boy, Billy boy?  
Oh, were have you been,  
charming Billy?

I have been to seek a wife;  
She's the joy of my life,  
she's a young thing  
and cannot leave her mother!

Did she ask you to come in  
Billy boy, Billy Boy?  
Did she ask you to come in  
charming Billy?

Yes, she asked me to come in,  
there's a dimple in her chin.  
She's a young thing  
and cannot leave her mother!



**Allegro**

Oh, where have you been, Bil - ly Boy, Bil - ly Boy? Oh

where have you been, charm - ing Bil - ly? I have

been to seek a wife; she's the joy of my life. She's a

young thing and can - not leave her moth - er!



# “Nesër kur të rritem”

- I -

Lela pa një bletë,  
ulur mbi një fletë,  
mbushur mjaltë plot,  
nis e na i thot':

- Refreni -

O moj bleta punëtore,  
s'le fush' e bregore,  
duke bredhur, duke hedhur,  
mjaltë për të mbledhur.

- II -

Sa zili të kam,  
sot e vogël jam,  
nesër kur të rritem,  
malit do t'i ngjitem.

- Refreni -

O moj bleta punëtore ...

- III -


Të mbjell mollë, të mbjell  
dardhë,  
fiq e rrush të bardhë,  
do t'i bëj un' këto vende,  
si kosheren tënde.

- Refreni -

O moj bleta punëtore ...

Allegreto

Teksti: R. Këlliçi  
Muzika: Z. Dino



Le - la pa një ble - të, u - lur mbi një fle - të,

Mbu-shur mjal-të plot Nis e na i thot' 1. thot' 2.

REF:

O moj ble - ta pu - në - to - re s'le fush' e bre - go - re,

D.C.

Du - ke bre - dhur, du - ke he - dhur mjal - të për të mble - dhur

# “Na llogarisni edhe ne”

## - I -

Si një këng' që po nis jemi ne,  
dhe jehon' në çdo fush' e në mal,  
Jemi forc' e madhe, jemi shumë ne,  
sot Atdheu n'krah't e tij dhe ne na ka.

## - Refreni -

Çdo gjë që bëhet në Shqipëri,  
që të lul'zojë i buk'ri Atdhe,  
dhe pse të vegjël jemi fëmij'  
na llogarisni edhe ne.

## - II -

Rrugët tona shkëlqejn' plot me drit',  
ti Atdhe ne na sjell veç pranver',  
fitoret tona si prin'drit tan', i mbrojm' edhe ne  
si kurdoher'.

## - Refreni -

Çdo gjë që bëhet në Shqipëri,



## Allegro



Si një këng' që po nis je - mi ne\_\_\_\_\_.



Dhe je - hon në çdo fush' e në mal\_\_\_\_\_.



je - mi forc' e ma - - dhe je - mi shu - më ne, sot At -



dhe - u n'krah't e tij dhe ne na ka\_\_\_\_\_.

## Ref:



Çdo gjë që bë - het në Shqi - - pë - ri.



Që të lul' - zo - jë i bu - kri At - dhe,



dhe pse të ve - - gjël je - mi fë - mij' na



llo - ga - ris - ni e - dhe ne\_\_\_\_\_.

## 5. VLERËSIMI

### Vlerësimi i nxënësit në klasat IV dhe V

Në klasën e IV dhe V fillon të rritet pesha e aspektit njohës në vlerësimin e nxënësit. Vlerësimi në klasat IV dhe V do të shërbejë si pikë lidhje ndërmjet vlerësimit në klasat I-III me ciklet më të larta. Vlerësimi “Shkëlqyeshëm” që përdoret si motivues në vlerësimin përshkrues në klasat I-III, në përgjithësi përdoret për nxënësit që janë mbi nivelin më të lartë të kërkuar nga kurrikula. Në këtë kategori hyjnë talentet, për të cilët arsimi ka programe të veçanta.

Për këtë arsye në klasën e IV dhe V nivelet e arritjeve përputhen me ato të klasave I-III dhe VI-XII si më poshtë:

| Klasa I-III                                  | Shkalla/Niveli | Klasa IV-V                    |
|--|----------------|-------------------------------|
| <i>Arritje të shkëlqyera</i>                 | 5 (Talenti)    | Ekselencia (10 <sup>+</sup> ) |
| <i>Arritje shumë të kënaqshme</i>            | 4              | Nota 9 - 10                   |
| <i>Arritje të kënaqshme</i>                  | 3              | Nota 7 - 8                    |
| <i>Arritje që kanë nevojë për përmirësim</i> | 2              | Nota 5 - 6                    |
| <i>Arritje të pakënaqshme</i>                | 1              | Nota 4                        |

### Llojet e vlerësimit

Vlerësimi periodik i nxënësit bëhet në përfundim të secilës periudhë dhe përmban tri nota, të cilat vendosen në regjistër në kolonat përkatëse të faqet e vlerësimit:

- *Nota e vlerësimit të vazhdueshëm (NVv);*
- *Nota e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse<sup>5</sup> (NTp);*
- *Nota e vlerësimit të portofolit<sup>6</sup> të nxënësit (NVp).*

| Vlerësimi periodik i nxënësit |     |     |                 |     |     |                  |     |     |
|-------------------------------|-----|-----|-----------------|-----|-----|------------------|-----|-----|
| Periudha e parë               |     |     | Periudha e dytë |     |     | Periudha e tretë |     |     |
| NVv                           | NTp | NVp | NVv             | NTp | NVp | NVv              | NTp | NVp |
|                               |     |     |                 |     |     |                  |     |     |

### Vlerësimi përfundimtar i nxënësit

Vlerësimi përfundimtar për secilën lëndë shënohet në regjistër duke plotësuar kolonat “Vlerësimi vjetor” dhe “Nota përfundimtare”.

<sup>5</sup> Duke u nisur nga specifikat e lëndëve që zhvillohen në arsimin fillor, mësuesi përcakton nëse në fund të secilës periudhë do të bëjë test për matjen e rezultateve kryesore të të nxënës; do t’u kërkojë nxënësve të punojnë dhe të prezantojnë një temë të caktuar apo një detyrë përmbledhëse; të prezantojnë një projekt; të realizojnë një punim për në ekspozitë; të përgatiten për një interpretim në një shfaqje artistike, teatrale etj.

<sup>6</sup> Specifikat e portofolit të nxënësit në arsimin fillor janë dhënë në kapitulli 7 “Portofoli i nxënësit”. Për vlerësimin e nxënësit për rubrikën “Vlerësimi i portofolit të nxënësit”, mësuesi duhet t’i referohet punimeve tematike, projekteve, punimeve individuale që bën nxënësi për çdo lëndë, sipas sugjerimeve të dhëna nga mësuesi, por edhe nismave vetjake që merr.

## Vlerësimi vjetor përmban:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar* (që bazohet në përparimin vjetor të nxënësit).
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse* (që bazohet në përgatitjen dhe qëndrueshmërinë vjetore të njohurive dhe të shkathtësive të nxënësit).
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit* (që bazohet në përpjekjet sistematike të nxënësit për të treguar interesin e tij për të nxënë, për të krijuar dhe për t'u përfshirë në nisma e veprimtari individuale ose në grup).

**Në rastet kur ecuria e nxënësit është e dukshme progresive ose regressive gjatë periudhës së dytë dhe të tretë të vitit, vlerësimi vjetor në secilën nga rubrikat mund të jetë progresiv ose regresiv.** Në rast kur ecuria e tij nuk është e qëndrueshme përgjatë tri periudhave, atëherë vlerësimi llogaritet me mesatare.

| Periudha e parë |                 |                 | Periudha e dytë |                 |                 | Periudha e tretë |                 |                 | Vlerësimi vjetor |                 |                 |
|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|------------------|-----------------|-----------------|------------------|-----------------|-----------------|
| NV <sub>v</sub> | NT <sub>p</sub> | NV <sub>p</sub> | NV <sub>v</sub> | NT <sub>p</sub> | NV <sub>p</sub> | NV <sub>v</sub>  | NT <sub>p</sub> | NV <sub>p</sub> | NV <sub>v</sub>  | NT <sub>p</sub> | NV <sub>p</sub> |
|                 |                 |                 |                 |                 |                 |                  |                 |                 |                  |                 |                 |

## Nota përfundimtare

Nxjerrja e Notës përfundimtare të nxënësit bëhet nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NV<sub>v</sub>).
- Përcaktohet nota vjetore e testit/e detyrës përmbledhëse (NT<sub>p</sub>).
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NV<sub>p</sub>).
- Shumëzohet secila prej notave me koeficientin e peshave për secilin lloj vlerësimi.

| Lloji i vlerësimit                        | Pesha në përqindje |
|---|--------------------|
| Vlerësimi i vazhdueshëm                   | 45%                |
| Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse | 30%                |
| Vlerësimi i portofolit të nxënësit        | 25%                |

- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë.  
Pra, formula që do të shërbejë për nxjerrjen e notës përfundimtare për secilën lëndë është:

$$(NV_v \times 0.45) + (NT_p \times 0.3) + (NV_p \times 0.25) = \text{Nota përfundimtare}$$

## Përshkrimi i notës

Nota përfundimtare shoqërohet me përshkrim. Ky përshkrim argumenton nivelin e

arritjeve të kompetencave të fushës/lëndës. Përshkrimi i referohet pikave më të forta që ka nxënësi lidhur me përmbushjen e kompetencave të lëndës.

| 1.1 Vlerësimi përfundimtar i nxënësit |                 |                 |                    |                    |
|---------------------------------------|-----------------|-----------------|--------------------|--------------------|
| Vlerësimi vjetor                      |                 |                 | Nota përfundimtare | Përshkrimi i notës |
| NV <sub>v</sub>                       | NT <sub>p</sub> | NV <sub>p</sub> |                    |                    |
|                                       |                 |                 |                    |                    |

## Vlerësimi i nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe

Në kurrikulën e re, nxënësit marrin vlerësim edhe për realizimin e kompetencave kyçe. Ky vlerësim bazohet në rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe për shkallën e parë dhe të dytë të kurrikulës. Në mënyrë të përmbledhur, në regjistër, në përfundim të vitit shkollor, mësuesi përzgjedh shprehjet e duhura vlerësuese për të treguar se *si* dhe *sa* komunikon nxënësi në mënyrë efektive, *sa* i ka të zhvilluara aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese, *sa* është i përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës, *sa* është i orientuar drejt së ardhmes, e ka të zhvilluar shpirtin e sipërmarrjes dhe është i motivuar të përmbushë objektivat që i vë vetes, *sa* përfshihet në mënyrë efektive në jetën familjare dhe shoqërore, *sa* përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët dhe *sa* i zotëron shkathtësitë themelore të përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar dhe shkëmbyer informacion.

## Portofoli i nxënësit

Në arsimin fillor, portofoli i të nxënit koleksionon të gjitha kontributet, arritjet e nxënësit në veprimtaritë që ai kryen në klasë, në shtëpi, punët me projekte, detyra krijuese, teste, detyra përmbledhëse, vlerësuese etj. Në arsimin fillor, është mësuesi ai që përcakton numrin dhe llojin e detyrave që bëhen pjesë e portofolit, duke u mbështetur në rubrikat e planifikimit sipas tri periudhave “Për çfarë i vlerësojmë nxënësit” dhe “Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës”.

Punimet dhe detyrat e koleksionuara në portofol janë mjete që i ndihmojnë nxënësit të zbulojnë anët e forta, dobësitë, mangësitë, vështirësitë dhe problemet që hasin gjatë procesit të punës. Ato dëshmojnë përparimin e nxënësve, aftësitë e tyre si dhe mundësitë për t’u përmirësuar më tej.

Organizimi i portofolit në rubrika lehtëson procesin e koleksionimit dhe të vlerësimit të nxënësit, ndikon në përcaktimin e kritereve dhe të peshave të çdo rubrike, rrit transparencën me prindërit dhe nxënësit në lidhje me vlerësimin, si dhe zhvillon aftësitë e nxënësit për të qenë i strukturuar.

Rubrikat e portofolit janë:

- Punime dhe detyra të realizuara në shtëpi (15% të vlerësimit)
- Punime dhe detyra të realizuara në klasë (30% të vlerësimit)
- Punime tematike/projekte dhe punime individuale të nxënësit (25% të vlerësimit)
- Teste, detyra kontrolli, detyra përmbledhëse (30% të vlerësimit)

Punimet që futen në portofol janë të larmishme dhe i japin mundësi çdo nxënësi të shfaqë dhe të tregojë çfarë di dhe çfarë është në gjendje të bëjë. Punimet dhe detyrat e shtëpisë dhe të klasës që futen në portofol kanë lidhje me përmbushjen e rezultateve të të nxënit të programeve lëndore të arsimit fillor dhe përcaktohen nga mësuesi.

Punimet tematike/projektet dhe punimet individuale janë sa të orientuara nga mësuesi, aq edhe të zgjedhura nga vetë nxënësi që dëshmojnë interesin e tij për të nxënë dhe bashkëpunimin në grup.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Shamku, Violeta

Muzika 4 : libër mësuesi / Violeta Shamku. –

Tiranë : Pegi, 2018

68 f. : me il. ; 18.2x25.4 cm.

ISBN 978-9928-233-02-8

1.Muzika 2.Tekste për mësuesit 3.Tekste për shkollat  
9-vjeçare

78 (072) (075.2)